

RAPORT VJETOR

KOLEGJI UNIVERSITAR
«INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË»
(Canadian Institute of Technology)

PËR
VITIN AKADEMIK
2020-2021

Tiranë, Dhjetor 2021

I. HYRJJE – BAZA LIGJORE DHE QËLLIMI I RAPORTIT

Ky raport është hartuar në zbatim të nenit 32, pikat 1-2 të ligjit Nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Urdhërave dhe Udhëzimeve të MASR.

Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” është licensuar për hapjen e programeve bachelor me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 781, datë 10/11/2011 “Për licensimin e ‘Instituti Kanadez i Teknologjisë’”.

Ndërsa në vitin 2012, me urdhër të Ministrit të Arsimit Nr. 487 datë 18/10/2012, “IKT” mori licensën për hapjen e programeve të ciklit të dytë.

Më 2 dhjetor 2016, përmes vendimeve Nr. 564, 565, 566, 567 të MAS, KU “IKT” u licensua edhe për hapjen e katër programeve të reja, dy në ciklin e parë bachelor dhe dy në ciklin e dytë, master i shkencave.

Po ashtu, gjatë shtatorit 2021 janë hapur edhe dy programe të reja, përkatësisht përmes Urdhërit Nr. 359 të MASR, datë 17.09.2021, programi Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni në Biznes” dhe përmes Urdhërit nr. 345 të MASR, datë 17.09.2021, programi Master i Shkencave në “Marketing Digjital”.

Institucioni është akredituar prej Bordit të Akreditimit të ASCAL, sipas vendimit nr. 116, datë 15.12.2017, për një periudhë 5 vjeçare.

Ky Raport Vjetor, i cili prezantohet në këtë dokument synon që të jap të dhëna dhe informacion për “Ministrinë e Arsimit dhe Sportit” lidhur me ecurinë e realizimit të objektivave të institucionit, organeve kolegjiale dhe atyre vendimmarrëse, programeve mësimore të zhvilluara, numrin e studentëve të regjistruar dhe të diplomuar, personelin mësimor-shkencor, gjendjen financiare dhe aspekte të tjera të veprimtarisë së institucionit.

Në të njëjtën kohë raporti përshkruan në mënyrë realiste gjendjen e institucionit në fillim, përgjatë dhe në fund të vitit akademik 2020-2021.

Gjithashtu dokumentacioni dhe të dhënat e vëna në dispozicion prezantojnë punën e bërë dhe rezultatet e arritura nga Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, i njohur si “Canadian Institute of Technology” (CIT) gjatë vitit akademik 2020-2021.

Qëllimi i këtij raporti është:

1. Informimi i institucioneve monitoruese dhe mbikqyrëse, partnerëve të biznesit, punonjësve, studentëve, dhe publikut të gjerë mbi realizimin e misionit të tij dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi duke i'u dhënë atyre një tablo të plotë, të saktë dhe të kuptueshme të veprimtarisë së KU “Instituti Kanadez i Teknologjisë”.
2. Të garantojë transparencën para institucioneve monitoruese dhe mbikqyrëse, punonjësve dhe studentëve, si dhe publikut të gjerë duke përgatitur dhe publikuar informacion të plotë, të saktë dhe të kuptueshëm mbi veprimtarinë e tij, programet e zhvilluara, rezultatet e arritura dhe aspekte të tjera të punës së këtij institucioni.

3. Të forcojë përgjegjshmërinë institucionale dhe publike nëpërmjet krijimit të një sistemi të llogaridhënies së vazhdueshme para mbikqyrësve, studentëve dhe palëve të tjera të përfshira.
4. Zbatimi i Ligjit të Arsimit të Lartë në Shqipëri etj.

INSTITUCIONI

II. INSTITUCIONI, OBJEKTIVAT DHE PËRMBUSHJA E TYRE

a) Realizimi i qëllimeve dhe objektivave të institucionit dhe njërive kryesore. **Përbushja e disa prej qëllimeve dhe objektivave kryesorë**

Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” ka ndjekur me rigorozitet misionin dhe objektivat e veta afatshkurtëra dhe ato afatmesme, për realizimin e planit vjetor akademik, atij strategjik si dhe dhe atij zhvillimor për përbushjen e qëllimeve të vendosura prej organeve të veta kolegjiale dhe atyre ekzekutuese.

Qëllimet kryesore të KU “IKT” për vitin akademik 2020-2021 kanë qenë si më poshtë:

1. *Zhfillimi institucional, zgjerimi dhe transformimi i KU “IKT” në një institucion dinamik dhe aktiv brenda e jashtë vendit;*
2. *Ndërkombëtarizimi i institucionit me tërheqjen e një stafi cilësor ndërkombëtar dhe me përvojë në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor ashtu dhe në tërheqjen e studentëve nga trojet shqiptare jashtë vendit, rajoni dhe më gjerë;*
3. *Ofrimi i një perspektive të re në rrafshin akademik, shkencor, kulturor, social e mediatik;*
4. *Zhvillimi i institucionit me fokus ofrimin e një arsimit cilësor dhe me standarde perëndimore;*
5. *Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me sipërmarrjet, industrinë, bankat, si dhe universitetet e tjera brenda e jashtë vendit;*
6. *Përfshirjen e institucionit, stafit akademik dhe studentëve në projekte dhe mobilitete të lidhura me Erasmus+, CEEPUS apo dhe ato që përfshijnë e angazhojnë aktorë më gjerë;*
7. *Mbështetja e studentëve në përparimin e tyre akademik e social përmes këshillimit, arsimimit, mbështetjes me aktivitete ekstrakurrikulare, angazhimit të tyre në jetën akademike dhe atë social-kulturore etj.;*
8. *Ndërtimi i një komuniteti gjithëpërfshirës, koheziv dhe bashkëpunues brenda kolegjit universitar;*
9. *Përforcimi i një kulture të gjerë në fushën e Kërkimit, Zhvillimit dhe Kreativitetit (RDC).*

Qëllimet e shprehura më sipër, kanë pasur në fokus që t’i shërbejnë interesave të vendit, komunitetit dhe stafit akademik të institucionit, bashkëpunëtorëve institucionalë si dhe aktorëve lokal, kombëtarë dhe atyre rajonal. KU «IKT» për vitin akademik 2020-2021 ka vazhduar të ofrojë programe studimi në dy cikle: në ciklin e parë dhe në ciklin e dytë, në gjuhën angleze, me fokus në edukimin cilësor dhe ka promovuar herë pas herë aktivitetet kurrikulare dhe ekstrakurrikulare në shërbim të studentëve.

Referuar më sipër, përmbledhurazi, qëllimi kryesor për vitin akademik 2020-2021 ka vijuar të jetë dhënia përparësi ndaj zhvillimit të kolegjit, ndërkombëtarizimit të tij përmes nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione homologe, sipërmarrje, banka, organizata të ndryshme dhe aktorë brenda e jashtë vendit. Në të njëjtën kohë përparësi i është dhënë, rritjes së numrit të studentëve, hapjes së programeve të reja në të dy fakultetet, afrimin e një stafi cilësor dhe me eksperiencë, përmirësimin e standardeve të mësimdhënies, kurrikulave; akreditimit e programeve; krijimin e një mjedisi të veçantë për aftësimin e studentëve, nxitjen e kërkimit shkencor brenda njërive bazë etj.

Qëllimet dhe objektivat vjetore të përcaktuara prej organeve kolegjiale janë përfshirë në të tëra detyrat dhe angazhimet ditore të të gjitha instancave ekzekutive akademike dhe administrative. KU “IKT” nisur nga situatat lidhur me pandeminë, ashtu dhe ato që kanë pasur të bëjnë me organizimin e procesit mësimor, ka synuar që të përmbushë të tëra standardet dhe kërkesat e studentëve dhe stafit akademik, duke i mundësuar atyre zhvillimin e procesit mësimor online dhe në klasë përmes mjeteve më të fundit të teknologjisë.

Edhe përgjatë vitit akademik 2020-2021, KU “IKT” ka vijuar të ofrojë programe dhe mësimdhënie në gjuhën angleze, përmes ofrimit të literaturës në marrëveshje me një ndër kompanitë më të njohura në rang botëror siç është McGrawHill Education. Kërkimi shkencor nga ana tjetër është shpërfaqur jo vetëm në tryezat e rrumbullakta, konferencat ndërkombëtare dhe projektet shkencore, por edhe në faqet e revistës CIT Review.

Gjithashtu IKT ka nisur të publikojë edhe buletin informativ “CIT Newsletter” përmes të cilit informohen jo vetëm studentët dhe stafi akademik për aktivitetet dhe ngjarjet apo zhvillimet në institucion, por edhe një audiencë më e madhe bashkëpunëtorësh e të interesuarish.

VIZIONI DHE MISIONI

Vizioni dhe misioni i institucionit sipas Statutit

Vizioni

Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” është i vendosur që të përgatisë studentë me aftësi të mbështetura mbi edukimin, vlerat dhe shpirtin etik, mendimin kritik, atë analitik dhe të orientuar drejt zgjidhjes së problemeve, kreativitetit, inovacionit dhe lidhshmërisë, të cilat ata do t’i përdorin për t’i dhënë formë jetës, karrierës dhe shoqërisë.

Misioni

Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” përmes promovimit të kurrikulave të përgatitura me kujdes, mësimdhënies, kërkimit shkencor, hapjes së programeve të reja, ka si mision zhvillimin e aftësive personale dhe mundësive, nxitjen e konkurrencës dhe përmirësimit të cilësisë së edukimit në shërbim të vlerave, duke vlerësuar dhe respektuar diversitetin kulturor dhe vlerat e Shqipërisë.

Kolegji Universitar e shpreh angazhimin e tij drejt këtij misioni përmes: Ofrimit të arsimit të lartë dhe veprimtarisë krijuese në fushën e inxhinierisë dhe të ekonomisë; Zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë akademike që kryhet brenda dhe jashtë vendit; Formimin e studiuesve të rinj në fushat teorike të vlerësimit, në fushën e inxhinierisë dhe të ekonomisë; Thellimin e kualifikimit profesional e shkencor të specialistit të lartë në fushën e inxhinierisë dhe të ekonomisë; Kryerjen e studimeve kërkimore - shkencore për të zhvilluar e tejçuar aplikime dhe inovacione në fushat e kërkimeve të inxhinierisë dhe të ekonomisë; Të ofrojë mundësitë më të mira për të përfituar nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës; Të kontribuojë në mbështetje të prioritetëve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit.

Nisur nga liria dhe autonomia akademike, KU “IKT” ofron programe studimi në përputhje me perspektivën dhe strategjinë e tij të zhvillimit, një strategji e qëndrueshme, e formuluar mbi bazën

e parimit se «një shkollë (institucion akademik IAL) e qëndrueshme është në gjendje të trajtojë problemet dhe nevojat aktuale», si dhe të ketë mundësinë e një menaxhimi për të garantuar një të ardhme të suksesshme për institucionin. Programet e ofruara prej KU “IKT” janë në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit.

ORGANIZIMI INSTITUCIONAL, ORGANET KOLEGJIALE DHE ATO VENDIMMARRËSE

Organet Drejtuese dhe Autoritetet Drejtuese, si dhe organe të tjera

Jeta institucionale, ajo akademike dhe administrative janë udhëhequr prej frymës statutore si dhe organeve të përcaktuara në këtë dokument kryesor të KU “IKT”.

Në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, organet drejtuese janë:

- a) Bordi i Administrimit
- b) Senati Akademik;
- c) Rektorati;
- d) Dekanatet;
- e) Asambletë e personelit akademik të njësive kryesore;

Organizma të tjerë kolegjal në rang komitetesh ose komisionesh :

- a) Këshilli i Etikës ;
- b) Komisioni i Përhershëm për Kërkimin Shkencor, Projektet, Aplikimet dhe Inovacionin;
- c) Komisioni i Përhershëm për Marrëdhëniet me Studentët dhe Garantimin e të Drejtave Studentore;
- d) Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;

Në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, autoritete drejtuese janë:

- a) Rektori;
- b) Dekanët;
- c) Përgjegjësit e Departamenteve;
- d) Drejtorët e Qendrave të kërkimit;
- e) Zv/Rektori dhe Zv/Dekanët;
- f) Administratori i Kolegjit;
- g) Administratorët e njësive kryesore;

Kolegji Universitar «Instituti Kanadez i Teknologjisë» ka vijuar të mbështes organizimin akademik institucional në rang njësish kryesore në dy fakultete, në atë të Inxhinierisë dhe atë të Ekonomisë.

Secili prej tyre organizohet si më poshtë:

1. FAKULTETI I EKONOMISË:

- *Departamenti i Administrim Biznesit;*
- *Departamenti i Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit;*
- *Njësia e Kërkimit Shkencor CIRD Ekonomi.*

2. FAKULTETI I INXHINIERISË:

- *Departamenti i Inxhinierisë Softuerike;*
- *Departamenti i Inxhinierisë Industriale;*
- *Njësia e Kërkimit Shkencor CIRD Inxhinieri.*

Forma e studimeve në “Institutin Kanadez të Teknologjisë” është ajo me kohë të plotë.

Statuti, Rregullorja Institucionale dhe “Libri i rregulloreve të institucionit” përcaktojnë detyrat, funksionet, përgjegjësitë dhe procesin e vendimmarrjes.

Të gjitha departamentet përbëhen më së paku nga 7 akademikë të punësuar me kohë të plotë, prej të cilëve minimalisht tre kanë gradë ose titull.

KU “IKT” ofron programe studimi të organizuara në dy fakultete, secila në njësinë përkatëse (departamentin përkatës). Programet e studimeve organizohen sipas sistemit 3 + 2 të Kartës së Bolonjës. Programet e studimeve të ciklit të parë (Bachelor) zgjasin 3 vite (180 ECTS), ndërsa ato të ciklit të dytë (Master i Shkencave) zgjasin dy vite akademike (120 ECTS).

Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, gëzon liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit.

➤ *Liria akademike garantohet nëpërmjet të drejtës:*

- a) për të organizuar veprimtaritë e mësimdhënies, ato të kërkimit shkencor si edhe veprimtaritë krijuese;
- b) për të hartuar dhe zhvilluar programet e studimit dhe për të përcaktuar fushat e kërkimit shkencor;
- c) për të organizuar procesin e promovimit të personelit akademik.

➤ *Autonomia financiare garantohet nëpërmjet të drejtës:*

- a) për të krijuar të ardhura të ligjshme nga veprimtaria e mësimdhënies, nga veprimtaritë kërkimore-shkencore, nga shërbimet etj;
- b) për të përfutur fonde nga shteti dhe organizata të tjera;
- c) për të caktuar rregulla të brendshme të financimit e të përdorimit të të ardhurave;
- d) për të përcaktuar tarifat e studimit;
- e) për të administruar pasuritë e luajshme dhe të paluajshme që disponon, në funksion të realizimit të misionit të tij, etj.

➤ *Autonomia organizative dhe e përzgjedhjes së personelit garantohet nëpërmjet të drejtës:*

- a) për t’u vetëqeverisur, për të përzgjedhur organizmat drejtuese, për të organizuar strukturat dhe rregulluar mënyrat e ushtrimit të veprimtarisë së tyre nëpërmjet akteve të brendshme (Statutit dhe rregulloreve të Kolegjit), të hartuara në përputhje me Ligjin dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi;
- b) për të përcaktuar kritere për pranimin e studentëve në programet e studimit në përputhje me Ligjin dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi;
- c) për të lidhur marrëveshje me persona juridikë, publikë dhe privatë, vendas ose të huaj, për veprimtari mësimdhënëse, kërkimore-shkencore, kualifikuese etj.;

d) për të caktuar në mënyrë të pavarur pagat e personelit, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së tij.

Veprimtaria e Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, zhvillohet në përputhje me rregullat dhe parimet e hapësirës evropiane të arsimit të lartë.

Komitetet dhe Komisionet institucionale, përbërja e tyre 2020-2021

1. Komisioni i Bursave

- Zv. Administratori, Ubejd Osmani - Kryetar
- Kryesekretare, Kostanca Kasapi
- MSc. Shefqet Meda- Përfaqësues i Fakultetit të Inxhinierisë
- MSc. Besarta Tafa – Përfaqësuese e Fakultetit të Ekonomisë
- Kamila Hyka – student

2. Komiteti i Shëndetit dhe Sigurisë

- Arben Bedo
- Klaudia Mersini
- Brunilda Kola
- Emërie Miftari

3. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

- Dr. Bledar Komina- Kryetar
- Prof. As. Dr. Artur Jaupaj
- Dr. Afrim Alimeti
- MSc. Julian Saraci
- Odeta Sipri - student

4. Komisioni i Përhershëm për Kërkimin Shkencor, Projektet, Aplikimet dhe Inovacionin

- Prof.Asoc.Dr Reis Mulita - Kryetar
- Dr. Blerta Nazarko
- Prof.Asoc.Dr Abdulsalam Alkohli
- Dr. Jona Puci
- Uendi Nelku – Student

5. Komisioni i Përhershëm për Kurrikulat dhe Programet Mësimore

- Prof.Asoc.Dr Vaso Qano – Kryetar
- Dr. Alfons Harizaj
- Dr. Bledar Kazia
- Dr. Edmira Cakrani

- Dr. Blendi Shima
- Dr. Bledar Komina
- Arber Gjonaj – student

6. *Komisioni i Përhershëm për Marrëdhëniet me Studentët dhe Garantimin e të Drejtave Studentore*

- MSc. Shefqet Meda – Kryetar
- MSc. Besarta Tafa
- MSc. Klea Capari
- MSc. Anxhela Bare
- Adela Lamçe – student
- Anisa Zaçe – student

7. *Këshilli i Etikës*

- Prof. Dr. Margarita Ifti - Kryetare
- Dr. Oriola Musa
- MSc. Shefqet Meda
- MSc. Antigona Lazaj
- Klejsi Dogjani - student

OBJEKTIVAT INSTITUCIONAL DHE ATO TË NJËSIVE KRYESORE PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021

Përveç qëllimeve të përmendura më sipër, Senati Aademik i KU “IKT” ka miratuar në fillim të vitit akademik 2020-2021 edhe objektivat vjetor, të ndarë në dy kategori:

i) Objektiva institucionale;

- Objektiva madhorë;
- Objektiva Specifik;
- Objektiva lidhur me projektet, ndërkombëtarizimin dhe kërkimin shkencor;

ii) Objektiva të njësive kryesore.

Në fillim të çdo viti akademik fakultetet, bazuar dhe në përputhje me qëllimin e institucionit si dhe objektivat institucionale, përcaktojnë objektivat e tyre vjetor të punës si dhe përzgjedhin strategjinë e realizimit të tyre.

Objektivat dhe strategjia e fakulteteve janë në përputhje me ecurinë e programeve, stafin akademik, infrastrukturën, studentët etj. Njëkohësisht këto objektiva janë në përputhje edhe me objektivat vjetor të institucionit dhe RDC (Kërkimit, Zhvillimit dhe Kreativitetit), të cilat së bashku me ato të fakulteteve miratohen me vendim Senati. Bazuar në Statutin e institucionit, KU “IKT” i ofron njësive kryesore, atyre bazë si dhe tërë stafit akademik të organizuar në organe kolegjiale lirinë dhe autonominë për:

- a) për të organizuar veprimtaritë e mësimdhënies, ato të kërkimit shkencor si edhe veprimtaritë krijuese;
- b) për të hartuar dhe zhvilluar programet e studimit dhe për të përcaktuar fushat e kërkimit shkencor;
- c) për të organizuar procesin e promovimit të personelit akademik, etj.

❖ Objektivat institucional

Objektivat kryesorë institucional për vitin akademik 2020-2021 kanë qenë si më poshtë:

Objektiva madhorë:

- Përditësimi i sistemit të menaxhimit online të institucionit;
- Rritja e interaktivitetit pedagogë-studentë përmes platformave virtuale dhe atyre të këshillimit online;
- Realizimi i një marrëveshje me një institucion të huaj për ekuivalentim diplomash ose ofrimin e diplomave të përbashkëta;
- Lidhja e marrëveshjes me Georgian College, Kanada, për njohje kreditesh për programet e ciklit të parë;
- Vijueshmëria e ofrimit të programeve të studimit sipas një cilësie të lartë;
- Të afrojë staf akademik me përvojë dhe t’i krijojë atij një ambient komod për të realizuar me studentët në mënyrën më të përshtatshme qëllimet e programit;

- Të nxjerrë studentë në tregun e punës që janë të pavarur dhe të orientuar për të arritur qëllimet e tyre;
- Të orientojë studentët drejt praktikës dhe pjesëmarrjes në kompeticione brenda dhe jashtë vendit;
- Institucion i orientuar drejt projekteve si me studentët ashtu edhe me partnerët;
- Rishikimi i programeve mësimore nën fokusin e bashkëbisedimit me grupet e interesit, biznesin si dhe kompani që operojnë në tregun e punës;
- Reklamimi dhe njohja e institucionit si dhe programeve që ai ofron gjerësisht.

Objektiva Specifik:

- Përfundimi i procesit të akreditimit të programeve të ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Kopjuterike dhe IT dhe Bachelor në Financë dhe Kontabilitet;
- Përmirësimi i programeve të lëndës (syllabuseve) për secilën kurrikul mësimore;
- Lidhja e marrëveshjeve të reja për praktikant mësimore për studentët, për t'i ofruar atyre mundësi të reja dhe të ndryshme në përfitimin e eksperiencave që do t'i adaptojnë më shpejt me tregun e punës;
- Përmirësimi i kurrikulave mësimore për programet Bachelor dhe Master;
- Përdorimi i literaturës më të fundit për programet e lëndëve, që do vazhdojë të realizohet sipas marrëveshjes së bashkëpunimit që KU "IKT" ka me "McGraw-Hill Education";
- Regjistrimi i studentëve sipas një mesatareje që tërheq studentë të mirë dhe shumë të mirë në programet e ofruara;
- Tek çdo program lënde minimalisht të përfshihet një projekt kursi i cili mund të realizohet individualisht ose në grup;
- Bashkëpunimi me studentët që janë diplomuar në këtë institucion (ALUMNI) për të ndjekur trendin e kërkesave të tregut, si dhe për të përmirësuar vetveten përmes vlerësimit të tyre.

Objektiva të lidhura me projektet, ndërkombëtarizimin dhe kërkimin shkencor

- Vijimi i marrëveshjes me "CEEPUS" për shkëmbim dhe mobilitet studentësh dhe stafi akademik;
- Pjesëmarrja në projektet e ERASMUS+ dhe hapësirat e krijuara për shkëmbim dhe mobilitet stafi dhe studentësh;
- Promovimi i RDC (Research, Development & Creativity - Kërkim, Zhvillimit dhe Krijimtarisë);
- Krijimi dhe mbështetja e një qendre të kërkimit shkencor ku të përfshihet stafi që merret me kërkim shkencor në institucion dhe njësitë kryesore,
- Aplikimi për projekte të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.
Të vijojë botimi me cilësi dhe indeksimi i revistës "CIT Review";
- Realizimi i konferencave seminareve dhe tryezave të hapura;
- Mbështetja e grupeve të kërkimit shkencor brenda fakulteteve;

❖ **Objektivat e Njësive Kryesore**

Objektivat e Fakulteteve për vitin akademik 2020-2021 miratuar prej Senatit Akademik, kanë qenë si më poshtë:

- Përfundimi i procesit të akreditimit të programeve të ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Kopjuterike dhe IT dhe Bachelor në Financë dhe Kontabilitet;
- Tek çdo program lënde minimalisht të përfshihet një projekt kursi i cili mund të realizohet individualisht ose në grup;
- Bashkëpunimi me studentët që janë diplomuar në këtë institucion (ALUMNI) për të ndjekur trendin e kërkesave të tregut, si dhe për të përmirësuar vetveten përmes vlerësimit të tyre.
- Rishikimi i programeve mësimore në fokusin e tryezave dhe takimeve me grupet e interesit, biznesin si dhe kompani që operojnë në tregun e punës;
- Vijueshmëria e ofrimit të programeve të studimit sipas një cilësie të lartë;
- Përdorimi i literaturës më të fundit për programet e lëndëve, që do vazhdojë të realizohet sipas marrëveshjes së bashkëpunimit që KU “IKT” ka me “McGraw-Hill Education”;
- Të orientojë studentët drejt praktikës dhe pjesëmarrjes në kompeticione brenda dhe jashtë vendit;
- Përmirësimi i kurrikulave mësimore për programet Bachelor dhe Master;
- Përmirësimi i programeve të lëndës për secilën kurrikul mësimore
- Realizimi i dy konferencave vjetore një për secilin fakultet;
- Lidhja e marrëveshjeve të reja për praktikat mësimore për studentët, për t’i ofruar atyre mundësi të reja dhe të ndryshme në përfitimin e eksperiencave që do ti adaptojnë më shpejt me tregun e punës.

REALIZIMI I OBJEKTIVAVE KRYESORË TË INSTITUCIONIT

KU “IKT” për vitin akademik 2020-2021 ka realizuar pjesën më të madhe të objektivave të përcaktuara në Senatin Akademik qofshin ato objektiva institucionale apo objektiva të njëjësive kryesore. Gjithashtu KU “IKT” ka analizuar me shumë kujdes edhe ato objektiva që janë përmbushur pjesërisht si dhe ato që për shkaqe madhore nuk kanë arritur të përmbushen.

Për të gjithë objektivat që nuk janë përmbushur plotësisht apo aspak, është vendosur shtyrja e tyre në vitin akademik pasardhës. Më poshtë jepet një përshkrim i shkurtër për përmbushjen me sukses të disa prej objektivave kryesorë.

➤ *Objektivi: Mbajtja e zgjedhjeve për senatin akademik dhe rektorin e institucionit*

Realizimi: Më datë 29.01.2021 u zhvilluan zgjedhjet për Senatin e ri akademik të Institutit Kanadez të Teknologjisë në zbatim të «Procedurës dhe afateve për zgjedhjen e anëtarëve të Senatit Akademik», dhe të “Udhëzimit për organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve për Senatin Akademik dhe Rektorin”.

Komisioni Institucional i zgjedhjeve, shpalli rezultatet për anëtarët fitues të Senatit Akademik në dt. 29.01.2021 dhe la një periudhë kohore prej 24 orësh (1 ditë) për apelim të rezultateve nga kandidatët për senator. Kryetari i komisionit bëri me dije se procesi zgjedhor, ishte korrekt dhe pa problem. Anëtarëve iu dorëzua Vërtetim –Mandati nga Senati Akademik duke e konsideruar Senatin të konstituar. Pas zgjedhjes së anëtarëve të Senatit Akademik, nëpërmjet një procesi zgjedhor korrekt, u ftuan anëtarët e tij të votojnë për zgjedhjen e Rektorit të “IKT”.

KIZ informoi se ishin depozituar dy kandidatura për rektor:

1. Prof.Dr. Sokol Abazi
2. Prof.Dr. Habib Hamam

Të dy kandidatët prezantuan përpara Senatit Akademik platformën e tyre të drejtimit të institucionit në mandatin e ardhshëm. Më pas u kalua në votim dhe në përfundim të procesit të votimit, nga numërimi rezultoi Prof.Dr. Sokol Abazi të kishte 7 vota, ndërsa Prof.Dr. Habib Hamam 3 vota.

Rektor i KU “IKT” u shpall Prof.Dr. Sokol Abazi. Lidhur me këto zgjedhje është njoftuar MASR sipas shkresave dhe njoftimeve përkatëse.

➤ *Objektivi: Zhvillimi me sukses i mësimin online*

Realizimi: Edhe për vitin akademik 2020-2021, IKT ka siguruar një stabilitet në zhvillimin e mësimin online sipas urdhërave dhe udhëzimeve të MASR. Kështu u morën të tëra masat, që ky vit akademik të zhvillohej sipas protokolleve të kërkuara brenda institucionit si dhe studentëve t’u sigurohej cilësi maksimale në mësimdhënie.

Prej kohe KU “IKT” ka përdorur platformën Google Classroom dhe Google Meet, në proceset e veta administrative institucionale, kështu që edhe përsa i përket mësimdhënies, partneri kryesor i IKT ka vijuar të mbesë Platforma Google, në të cilën institucioni bën pjesë. Institucioni dhe stafi akademik ka bërë përpjekje maksimale për të mbështetur studentët në nxënien e njohurive, ashtu si dhe në mbështetjen e tyre sa i përket problemeve të hasura. Çdo gjë ka shkuar më së miri dhe janë ndjekur me përpikmëri udhëzimet përkatëse të ministrisë së linjës si dhe të asaj të Shëndetësisë.

➤ **Objektivi: Diversifikimi i jetës akademike në kampusin e ri**

Realizimi: Viti akademik 2020-2021 e gjeti KU «IKT» të zhvendosur në ambiente të reja infrestrukturore dhe mësimore, duke sjellë një zgjerim më të madh dhe duke qendruar po brenda qytetit të Tiranës, shumë pranë qendrës së saj. Kështu institucioni u zgjerua duke lëvizur prej Qendrës Zayed, Rruga Andon Zakon Çajupi, në një hapësirë të re që ofronte mundësi të shumta për stafin dhe studentët. Kështu IKT vendosi të marrë hapësira të konsiderueshme me qera në Kompleksin Xhura, Rruga Xhanfize Keko, Nr.12, Tiranë, në të cilën zhvillon dhe aktivitetin e vet institucional, akademik dhe mësimor. Brenda kësaj hapësire janë organizuar të gjitha ambientet për zhvillimin e jetës akademike, mësimore, kërkimore, rekreative si dhe administrative. Për këto ambiente institucioni disponon Aktin Kundër Zjarrit me Nr. Prot. C-10325/1, datë 24.05.2021 dhe Aktin Higjierno Sanitar Nr. 171, datë 24.05.2021.

➤ **Objektivi: Nënshkrimi i marrëveshjeve institucionale me partnerë, universitete e sipërmarrje**

Realizimi: Në kuadër të fuqizimit të institucionit, ndërkombëtarizimit të tij si dhe krijimit të marrëdhënieve solide, KU “IKT” është angazhuar që të nënshkruaj memorandume mirëkuptimi dhe marrëveshje angazhimi e partneriteti me shumë institucione të ndryshme, si nga bota akademike ashtu dhe nga industria dhe sipërmarrja.

Bashkëpunimi, me partnerë kombëtarë apo ndërkombëtarë është një nga synimet kryesore të KU “IKT” për të cilin punohet në mënyrë të vijueshme dhe aktive. Institucioni ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh në frymën e bashkëpunimit, shkëmbimit të stafit akademik për periudha të caktuara kohore, apo dhe për të favorizuar mobilitetin e studentëve, si psh. CEEPUS, Erasmus +, etj.

Nëse do të mund t’i ndanim marrëveshjet e nënshkruara, ato janë të 4 kategorive:

- *Për mobilitete studentore dhe të stafit akademik*
- *Për praktika mësimore*
- *Projekte, konferenca dhe tryeza të përbashkëta ku mund të përfshihet stafi dhe studentët*
- *Për mundësi bashkëpunimi të ndryshme, njohje kreditesh dhe mundësi për diploma të përbashkëta.*

(Një listë e marrëveshjeve jepet në tabelën nr.2)

➤ **Objektivi: Vijon me sukses përdorimi i literaturës më të fundit sipas marrëveshjes së bashkëpunimit mes KU “IKT” dhe “McGraw-Hill Education”**

Realizimi: Që prej vitit 2016 e deri më sot, IKT vazhdon të mbajë aktive marrëveshjen me një ndër kompanitë më të njohura dhe më serioze në tregun global të ofrimi të literaturës akademike siç është **McGraw-Hill Education**.

Duke qenë se marrëveshja përfundoi me vitin akademik 2020-2021, institucioni vendosi që ta rinovojë sërish këtë marrëveshje për një term të ri 3-vjeçar, duke siguruar garancinë e një literature moderne, me të cilën edukohen breza të tërë studentësh njësoj si në institucionet homologe në Perëndim e më gjerë.

Literatura me të cilën kjo kompani furnizon universitetet është jo vetëm ndër më të pasurat por dhe ndër më të përditësuarat dhe i mundëson stafit të institucionit dhe studentëve një larmi të

madhe përzgjedhje dhe shërbimesh të cilat lehtësojnë marrëdhënien pedagog-student si dhe ndihmojnë procesin e mësimdhënies e mësimnxënies.

Gjithashtu studentët kanë mundësinë të kenë në dorë të njëjtën literaturë më të cilën studiojnë bashkëmoshatarët e tyre në vendet më të zhvilluara. Bazuar në marrëveshjen e nënshkruar midis dy palëve institucioni ka krijuar një garanci në fushën akademike duke qenë se kompania është një ndër dy kompanitë më të mëdha në botë që ofrojnë këtë lloj shërbimi.

Gjithashtu mundë të thuhet se shërbimi për stafin akademik jepet pa pagesë, duke përfutur pa limit prej platformës, gjë e cila i mundëson stafit që të ketë dhe përdori një literaturë të pasur në kërkimin shkencor dhe të përditësohet me publikimet më të fundit të monografive dhe literaturës në fushën që mbulon.

- **Objektivi: Përmbyllja me sukses e procesit të akreditimit të programeve Bachelor në “Financë dhe Kontabilitet” dhe Bachelor në “Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni”**

Realizimi: Procesi i akreditimit të programeve Bachelor në “Financë dhe Kontabilitet” dhe Bachelor në “Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni” nisi që në fillim të vitit kalendarik 2020 dhe përfundoi në muajt korrik-gusht 2020 me vizitën e vlerësuesve të jashtëm të ASCAL.

Në muajin dhjetor i tërë ky proces u përmbyll me shpalljen e vendimit të Bordit të Akreditimit për vlerësimin e të dy programeve maksimalisht.

Sipas vendimit të BA të ASCAL për të dy programet u mor një vlerësim maksimal për 6 vite akademik për bachelorin në Financë dhe Kontabilitet, ndërsa për programin e dytë, bachelorin në Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni, një vlerësim shumë i mirë për 5 vite akademike.

- **Objektivi: Angazhimi i një stafi të kualifikuar me grada e tituj**

Realizimi: Përgjatë vitit akademik 2020-2021 KU “IKT” angazhoi në mësimdhënie një staf me eksperiencë dhe me grada e tituj në fushat përkatëse të programeve të studimit. Po ashtu institucioni vijoi të ruaj stafin e vet të brendshëm si dhe të rekrutoj staf me eksperiencë dhe të përgatitur aty ku ishte e domosdoshme.

Cilësia e stafit të angazhuar me kohë të plotë dhe atij me kohë të pjesshme mund të shihet në tabelën nr. 1, si më poshtë.

Sipas indikatorëve të tabelës për vitin 2020-2021 numri i stafit të KU “IKT” me Tituj dhe Grada shkencore ka ardhur në rritje. Për të dy fakultetet përbërja e stafit është si vijon:

Staf i brendshëm: 5 Prof.Dr; 6.Prof.As; 16 Dr; Dr në proces 2, 12 MSc;

Staf akademik me kohë të pjesshme: 5 Prof As; 1 Dr.; 1 MSc.

Gjithsej janë 27 anëtarë me kohë të plotë të stafit akademik me grada dhe tituj (64%) dhe 15 me master (26%).

KU “IKT” edhe për vitin e ardhshëm akademik synon që të tërheq stafi të kualifikuar, me grada e tituj shkencorë, me ekspertizë të dalluar në fushën e inxhinierisë dhe ekonomisë.

➤ **Objektivi: Mbështetja e stafit në kualifikimet pasuniversitare**

Realizimi: Ashtu si dhe çdo vit tjetër, Kolegji Universitar «Instituti Kanadez i Teknologjisë» ka vijuar të mbështes stafin akademik drejt rrugës së rritjes së performacës, por edhe duke i mbështetur që kjo rritje cilësore të këtë baza solide në edukimin dhe formimin e tyre. Kjo gjë arrihet përmes mundësisë që stafi akademik të ndjek studimet doktorale, gjë e cila sjell për institucionin dhe studentët edukim cilësor dhe përditësim me të rejtat më të fundit të shkencës në fushën e inxhinierisë dhe të ekonomisë. Brenda vitit akademik 2020-2021, janë disa anëtarë të stafit akademik, të cilët janë në përfundim të studimeve të Doktoraturës dhe së shpejti do t’i bashkëngjiten stafit të institucionit si staf me eksperiencë dhe me gradë shkencore të mbrojtur. Mbi 70 përqind e stafit akademik të brendshëm të institucionit është me grada e tituj, duke ndihmuar kështu në rritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor.

Gjithashtu një mbështetje e konsiderueshme për stafin akademik që ndjek studimet doktorale, por edhe për ata që duan të marrin titujt akademik, është mundësia që IKT u ofron që të publikojnë pa asnjë pagesë artikujt e tyre shkencor në revistën CIT Review, dhe po e njëjta politikë është ndjekur edhe për pjesëmarrjen në konferencat shkencore që institucioni ka organizuar e vazhdon të organizojë.

➤ **Publikimi periodik i revistës “CIT Review” dhe përfshirja e saj në Ulrichsweb™ si dhe indeksimi në Citefactor**

“CIT Review” është revistë shkencore periodike e KU «IKT», e cila numrin e saj të parë e publikoi në vitin 2014 dhe që nga ajo kohë në të publikohen artikujt shkencorë të stafit akademik të të dy fakulteteve si dhe të studiuesve që shprehin interes publikimi nga institucione të tjera.

CIT Review është revistë shkencore me disa parametra ku dallohen qartësisht:

- *Reviste me Open Access;*
- *Vizibilitet në databazat e revistave shkencore;*
- *Bord editorial dhe bashkëpunëtorësh ndërkombëtar ku spikasin emra të njohur të botës akademike e shkencore;*
- *Revistë me proces Peer-Review;*
- *Pjesë e databazës Ulrichsweb™ Periodicals Directory;*
- *Indeksuar në Citefactor.*

Revista mbulon kryesisht fushën e inxhinierisë, atë të ekonomisë si dhe fusha shkencore të përafërta më dy të parat, si shkencat e natyrës, ato humane etj. Së fundi gjatë vitit 2021, si një arritje më vete, CIT Review është bërë pjesë e databazës Ulrichsweb™ Periodicals Directory dhe indeksuar në Citefactor, që është dhe indeksimi më i madhë i revistave shkencore dhe artikujve shkencor në botë.

Si një revistë e mirëfilltë shkencore me ISSN dhe një bord personalitetesh të shquara ndërkombëtare në fushën e shkencës. Kjo revistë i jep mundësi stafit akademik të KU “IKT” si dhe grupeve të kërkimit shkencor, që të publikojnë gjetjet dhe arritjet e tyre dhe të rrisin

bashkëpunimin me anëtarët e bordit të revistës që janë edhe personalitete të shquara në universitete të huaja.

Bordi Editorial:

Assoc. Prof. Dr. Vaso Qano, Canadian Institute of Technology, Albania; Prof. Dr. Llukan Puka, Canadian Institute of Technology, Albania; Prof. Dr. Klodiana Gorica, University of Tirana, Faculty of Economy; Assoc. Prof. Dr. Artur Jaupaj, Canadian Institute of Technology, Albania; Dr. Albana Demi, Aleksandër Moisiu University, Albania.

Bordi Editorëve:

Prof. Dr. h. c Heinz-Dieter Wenzel, Otto-Friedrich-Universität Bamberg, Germany; Prof. Dr. Franco Nardini, Bologna University, Italy; Prof. Dr. Shkëlqim Cani, Canadian Institute of Technology, Albania; PhD. Franco Moglie, L'Università Politecnica delle Marche, Italy; Assoc. Prof. Dr. Arjan Durrësi, Indiana University-Purdue University School of Science, USA; John Tizard, Independent strategic adviser Professor; Arben Çela, Université Paris-Est, Paris; PhD. Eldi Metushi, Canadian Institute of Technology; Dr. Altin Kulli, Canadian Institute of Technology; Dr. Fabjan Lashi, Canadian Institute of Technology; Dr. Blendi Shima, Canadian Institute of Technology; PhD. Afrim Alimeti, Canadian Institute of Technology ; Dr. Bledar Kazia, Canadian Institute of Technology ; Dr. Edmira Cakrani, Canadian Institute of Technology.

Të dhënat për revistën:

CIT REVIEW (CIT rev.) online publication recorded permanently in the ISSN Register as follows:

ISSN 2788-645X

Key title: CIT Review Journal

Faqja zyrtare e revistës: <https://crj.cit.edu.al/>

➤ ***Objektivi: Rritje cilësore dhe mbështetje për aktivitetet shkencore e kulturore në institucion***

Realizimi: Në mbështetje të realizimit të objektivave si dhe për të shtrirë më tej realizimin e planit vjetor, por dhe për të fuqizuar mbështetjen studentore dhe atë akademike, fakultetet dhe institucioni kanë arritur të organizojnë disa aktivitete kryesore siç janë:

- Marrëveshje në mbështetje të studentëve dhe stafit:	32
- Leksione të hapura dhe seminare:	9
- Trajnime:	11
- Konkurse, hackathon:	4
- Start up-e:	2
- Shkolla verore:	2
- Konferenca:	3
- Mobilitete akademike (staf):	4 (2 nga CIT dhe 2 të ardhur në CIT)
- Mobilitete studentore:	5
- Aplikime për projekte:	4
- Projekt i fituar:	1
- Revistë shkencore e botuar:	2 numra

- *Licenca* 2 (Microsoft, CISCO Academy)
- *Udhëtime turistike studentësh* 2

➤ ***Objektivi: Ofrimi i praktikave mësimore për studentët në bashkëpunim me sipërmarrjen, industrinë dhe bankat***

Realizimi: Siç është përmendur më sipër në objektivin e nënshkrimit të marrëveshjeve institucionale, “IKT” ka vijuar të konkretizojë marrëveshje dhe bashkëpunime të reja për vitin akademik 2020-2021 përmes të cilave u ka ofruar studentëve mundësi të ndryshme për praktika mësimore në institucione të konsoliduara dhe të njohura në treg. KU “IKT” beson se bashkëpunimi me sipërmarrjen, industrinë dhe bankat është nyja për t’u siguruar studentëve mundësinë që eksperiencia e tyre të plotësohet edhe me pjesën praktike dhe të prekshme të dijës dhe aftësive që ata marrin në universitet.

Ndër marrëveshjet kryesore të firmosura përgjatë këtij viti akademik mund të përmenden ato me WVP Management Albania, Deloitte Albania, Balkans Capital, Digital Academy, Bashkia Tiranë, 2RM lab shpk. Xhaferraj Kontabilitet, RVA, People in Focus, UNICEF Albania, Online Marketing Academy, Banka Credins, Continental Hospital, GIZ dhe Germin, Banka UBA, Lufthansa Industry Solutions, ALSE, etj.

➤ ***Objektivi: Aplikimi për mobilitete në kuadër të programit CEEPUS***

Realizimi: Në kuadër të bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe të qenurit pjesë e organizmave akademik si dhe rrjeteve të njohura Evropiane akademike, KU “IKT” ka përforcuar lidhjet e veta me programin CEEPUS dhe të tëra institucionet arsimore që marrin pjesë në të.

Brenda kësaj marrëveshje të nënshkruar që në vitin 2016 kur CIT u bë pjesë e CEEPUS, në vitin akademik 2020-2021, pas periudhës së vështirë të pandemisë ku u ndalua edhe lëvizja, si mobilitete akademik kanë pasur mundësi të lëvizin 2 personel akademik dhe 1 student.

➤ ***Objektivi: Aplikimi për mobilitete në kuadër të programit ERASMUS+***

Realizimi: Në pajtimi me interesat institucionale si dhe mbi marrëdhëniet e krijuara prej disa vitesh me institucionet partnere në kuadër të Erasmus+, KU “IKT” ka mbështetur aplikimet e stafit akademik si për projekte ashtu dhe për mobilitete në këtë organizëm të madh të BE. Në tabelen nr. 3 të këtij raporti jepen disa të dhëna lidhur me projektet e aplikuar në kuadër të thirrjeve Erasmus, ndërkohë që për vitin akademik 2020-2021, kanë përfutuar prej mobiliteteve, 4 studentë të IKT që kanë shkuar: 3 prej tyre në Nysa University, Poloni, dhe 1 student i IKT që ka shkuar në Troyes University, Francë.

Ndërkohë që në IKT në kuadër të mobiliteteve Erasmus, kanë ardhur: 1 student prej Business School of Tampere University of Applied Science; dhe 1 staf administrativ i Zyrës për Marrëdhënie me Jashtë i Ceske Bodujevske University, Republika Çeke.

➤ ***Objektivi: Institucion që orienton studentët dhe aftësitë e tyre drejt projekteve dhe aftësive praktike***

Realizimi: IKT ka synuar dhe vijon të mbështes objektivin: për të qenë një institucion i “orjentuar drejt projekteve”, pra që studentët të mësojnë dhe praktikojnë aftësitë e tyre në praktikë, qofshin ato individuale ose në grup. Të gjitha programet që ofron KU “IKT” janë në përshtatje me misionin, vizionin e institucionit si dhe objektivat e vendosur. Programet e lëndës sipas kurrikulave përkatëse pasurohen dhe përditësohen duke reflektuar një literaturë bashkëkohore në gjuhën angleze si dhe përfshijnë aftësi (*skills*) të cilat mbështesin përparimin e studentëve drejt nevojave të tregut.

Në të njëjtën kohë, bazuar dhe në objektivat e institucionit si dhe në ato të njësive kryesore, të përmendura në fillim të raportit, secila prej lëndëve synon që të ketë një projekt në përfundim të saj, të realizuar nga studentët. Projektet janë pjesë e vlerësimit të studentit, apo studentëve nëse ato bëhen në grup.

➤ **Objektivi: Aftësimi i studentëve përmes soft skills dhe organizimit të trajnimeve që mbështesin zhvillimin e karrirës së tyre**

Realizimi: Lidhur me këtë objektiv, institucioni është përpjekur që studentëve t’u ofrojë mundësi të shumta për të përforcuar njohuritë që marrin si dhe për të zhvilluar aftësitë organizative si dhe ato të punës në grup. Për këtë gjë janë organizuar trajnime të ndryshme si dhe urokshope për studentët që ndjekin studimet në IKT.

Ndër trajnimet që janë organizuar me këtë fokus janë:

- Praktikë një mujore pranë Qendrës së Inovacionit, Kërkimit dhe Zhvillimit (CIRD) dhe Institutit të Trashëgimisë dhe Turizmit (IEHT) për studentët e CIT, 10.09.2020
- Organizimi i trajnimit në «Devops Culture», nga Ing. Arlind Qirjazi, MSc në Inxhinieri Telekomunikacioni dhe me më shumë se 15 vjet që punon në IT duke mbuluar role dhe pozicione të ndryshme, 29.06.2021
- Trajnim për CIT ALUMNI, në «Financa 5», 17-24 prill 2021. Trajnimi u mbajt nga MSc.Gjergji Tafa.
- Trajnim për mësuesit dhe studentët «Online Teaching Platforms», mbajtur nga pedagogu Bledar Kazia, në bashkëpunim me IETT, 27 nëntor 2020.
- Realizimi i Workshp-it virtual për studentët e CIT «Si të përgatisësh një CV», mbajtur prej pedagogut Saimir Mansaku, 27 maj 2021.
- Mbajtja e sesionit trajnues për studentët dhe stafin e CIT prej Dr. Edmira Cakrani «Ekonometria», 26 maj, 2021.

➤ **Objektivi: Krijimi i lehtësirave për studentët që duan të ndjekin studimet në IKT**

Realizimi: Për të mbështetur studentët që duan të studiojnë në IKT por që për arsye të ndryshme nuk kanë arritur të gjejnë support financiar, institucioni ka siguruar dy marrëveshje që mbështesin përpjeket e tyre në këtë drejtim.

Marrëveshjet janë si më poshtë :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” (CIT) dhe Bankës Credins - marrëveshje për t’i ofruar studentëve të CIT mundësinë për të financuar në masë 100% studimet e tyre në bankën Credins me normë interesi 0% brenda 24 orëve, 04.09.202

- Realzimi i marrëveshjes së partneritetit mes Finex dhe Institutit Kanadez të Teknologjisë (CIT), 29.10.2020. Shoqata Finex ofroi 25% zbritje në tarifën e trajnimeve në fushën e financës dhe kontabilitetit për studentët dhe stafin e CIT.

c) Informacion mbi kërkimin shkencor në IAL

Ndër aktivitetet e ndryshme me karakter shkencor ku janë angazhuar si stafi akademik mësimdhënës e shkencor ashtu dhe studentët përgjatë këtij viti akademik, përmenden:

Leksione të hapura, seminare dhe konferenca

- Mbajtje e leksionit të hapur “Menaxhimi i sistemeve të informacionit dhe literatures ‘McGraw Hill’”, mbajtur prej pedagogut të Fakultetit të Ekonomisë, Saimir Mansaku online dhe Radio Kontakt, 29.09.2020
- Mbajtja e Auditoriumit të 5-të Virtual “Sfidat e sistemit financiar gjatë valës së dytë të CoVid-19”. Organizuar nga Fakulteti Ekonomik, konkretisht Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit në bashkëpunim me strukturat e brendshme dhe të jashtme, 06.10.2020. Të ftuar special ishin Prof.Dr. Arben Malaj dhe Prof.Dr. Shkelqim Cani.
- Pjesëmarrje e stafit në Konferencën Ndërkombëtare për «Mësimin Dixhital Afatgjatë», e cila u mbajt në datat 03-04 tetor në Vlorë, Shqipëri.” Morën pjesë, kryetari i Bordit të Administrimit, Prof.Assoc. Ramiz Zekaj dhe Pedagogu Shefqet Meda.
- Organizimi i leksionit të hapur: "Teknologjia Blockchain: Bitcoin dhe përtej", ku folës ishin Dr. Sourav Sen Gupta lektor në Shkollën e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë në NTU Singapore dhe MSc. Shefqet Meda, pedagog i CIT, 30.06.2021
- Organizimi i leksionit të hapur: «Ruajtja e mendësisë sipërmarrëse si kompetencë kyçe për inovacion» me lektore PhD. Valentina Ndou, 23.06.2021

Trajnime

- Trajnim mbi Platformën Google Meet për stafin e CIT, 26.10.2020
- Praktikë një mujore pranë Qendrës së Inovacionit, Kërkimit dhe Zhvillimit (CIRD) dhe Institutit të Trashëgimisë dhe Turizmit (IEHT) për studentët e CIT, 10.09.2020
- Organizimi i trajnimit në «Devops Culture», nga Ing. Arlind Qirjazi, MSc në Inxhinieri Telekomunikacioni dhe me më shumë se 15 vjet që punon në IT duke mbuluar role dhe pozicione të ndryshme, 29.06.2021
- Trajnimi i stafit pedagogjik të shkollës «Ismail Qemali» mbi Platformat e Mësimdhënies Online, 24, 09, 2021.
- Trajnim për CIT ALUMNI, në «Financa 5», 17-24 prill 2021. Trajnimi u mbajt nga Gjergji Tafa.
- Trajnim për mësuesit dhe studentët «Online Teaching Platforms», mbajtur nga pedagogu Bledar Kazia, në bashkëpunim me IETT, 27 nëntor 2020.
- Trajnim mbi «Sigurimin e Cilësisë dhe Google Classroom Platform», mbajtur më 14 tetor 2021, prej Prof.Vaso Qano, Dr. Bledar Komini, Dr. Blendi Shima.
- Trajnimi për stafin e CIT në «Dizajn dhe Photoshop», i cili zgjati një muaj (nisi më 18 dhjetor 202) dhe u mbajt nga studentja Jona Shtini, 04 shkurt 2021 u shpërndanë certifikatat.

- Realizimi i Workshopit virtual për studentët e CIT «Si të përgatisësh një CV», mbajtur prej pedagogut Saimir Mansaku, 27 maj 2021.
- Mbajtja e sesionit trajnues për studentët dhe stafin e CIT prej Dr. Edmira Cakrani «Ekonometria», 26 maj, 2021.
- Trajnimi nga Departamenti i IT i stafit akademik të CIT mbi «Google Meet Platform», 26 nëntor 2020.

Konkurse, start up-e dhe shkolla verore

- Shpërblimi i studentëve fitues të Shkollës Verore, për prezantimin e Start up-it më të mirë, të cilëve ju dhuroar çmime dhe bursa për më të mirët, 12.07.2021.
- Konkursi kombëtar i matematikës – CIT organizoi në rang kombëtar konkursin e matematikës, në përfundim të të cilit u shpërndanë çmime si dhe u shpërblyen më të mirët, 06.07.2021
- Shkolla Verore CIT, e organizuar për maturantët e gjimnazeve të ndryshme në vend. Kjo shkollë verore zgjati dy javë dhe u zhvillua në ambientet e CIT, ku maturantëve ju mundësua të mësojnë ide dhe aftësi të reja për botën e sipërmarrjes, inovacionit dhe teknologjisë. Ata u trajnuan dhe udhëzuan nga profesorë dhe ekspertë nga institucioni.
- Studentët e CIT bëhen pjesë e bërthamës që punon mbi zgjidhjet dixhitale si pjesë e programit ConnectIT të BE-së për Inovacionin. Pjesë e këtij projekti u bënë studentët Kristi Nene, Jona Shtini, Arlinda Doçi, Ornela Loloçi, Greisa Kalbaj dhe Adrian Hyseni, 16.07.2021, në përfundim atyre ju dha një certifikatë vlerësimi dhe pjesëmarrje.
- «Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve», organizuar mes UNICEF Albania dhe CIT, ku u mbajtën disa prezantime mbi platformën U-Report Albania. Kjo platformë synon përfshirjen e zërit të të rinjve në proceset politikëbërëse dhe ofrimin e zgjidhjeve për çështjet që i prekin me shumë, 16.07.2021

Shkëmbime stafi

- Instituti Kanadez i Teknologjisë mirëpriti Anna Shirkova dhe Simon Chzek, përfaqësuesit e 'Institutit të Teknologjisë dhe Biznesit' nga Ceske Budejovice, Republika Çeke, në kuadër të marrëveshjes së nënshkruar Erasmus+, 02.08.2021
- Pjesëmarrje në Shkollën Verore të Universitetit «Rzeszow», Poloni, në të cilën morën pjesë Zv. Rektori, Prof. Vaso Qano, Ing. Shefqet Meda dhe studentja Greta Germizi, 17.07.2021.
- Vajtja e 3 studentëve të IKT në Nysa University në Poloni, për një semestër dhe; 1 student në
- Ardhja në IKT e një personeli, staf nga Zyra për Marrëdhëniet me Jashtë prej Ceske Bodujevske, Republika Çeke
- Ardhja e një studenti nga Tampere University School of Applied Science, një semestër.

Konferenca

- Organizimi i Konferencës Ndërkombëtare me titull: “Shaping the Future: Digital Economy and Recent Technology”¹, 23 Prill, 2021, me bashkëpunëtorë: CIRD, UPT, UET, IETT, Albanian

¹ <https://cit.edu.al/icedrtt-2021-conference/>

University, Universiteti i Elbasanit «Aleksandër Xhuvani», UBA Bank, “Mother Theresa” University North Macedonia, University of Neë York Tirana, International University of Sarajevo, etj.

- Organizimi më datë 30 shtator-1 tetor 2021, i Hackathonit të parë ndërkombëtar të CIT: «Hack-Tech 2021 – Cybersafety for Kids», në bashkëpunim me Qeverinë Studentore të CIT, Universitetin e York në Toronto, Kanda, dhe me bashkëpunëtorë si UNICEF Albania, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Observatori për të Drejtat e Fëmijëve, ALO 116 për fëmijët, Lufthansa Industry Solutions co.

- Organizimin në bashkëpunim me Albanian University të «Konferenca e III-të Studentore “Inovacion në Inxhinieri, Shkencë dhe Teknologji», 07.05.2021

- Organizimi më 09 qershor, 2021, i konferencës studentore, «Sfidat e Biznesit në Epokën Digjitale», në bashkëpunim me: IETT, Rrjeti Rinor IETT, Albanian University, dhe Fakulteti i Ekonomisë i Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë.

- Bashkëpunimi me Aleancën Franceze dhe Ambasadën Franceze për organizimin e Hackathonit kombëtar «ViaEgnatia 2.0», 27 nëntor 2020.

Publikimi i revistës shkencore CIT Review

“CIT Review” është revistë shkencore periodike e KU «IKT» që publikon artikujt shkencorë të stafit akademik të të dy fakulteteve si dhe të studiuesve që shprehin interes publikimi nga institucione të tjera. Revista publikohet dy herë në vit, përkatësisht në muajin nëntor dhe në muajin maj.

Revista mbulon kryesisht fushën e inxhinierisë, atë të ekonomisë si dhe fusha shkencore të përafërta më dy të parat, si shkencat e natyrës, ato humane etj. Së fundi gjatë vitit 2021, si një arritje më vete, CIT Review është bërë pjesë e databazës Ulrichsweb™ Periodicals Directory dhe indeksuar në Citefactor, që është dhe indeksimi më i madhë i revistave shkencore dhe artikujve shkencor në botë. Si një revistë e mirëfilltë shkencore me ISSN dhe një bord personalitetesh të shquara ndërkombëtare në fushën e shkencës. Kjo revistë i jep mundësi stafit akademik të KU “IKT” si dhe grupeve të kërkimit shkencor, që të publikojnë gjetjet dhe arritjet e tyre dhe të rrisin bashkëpunimin me anëtarët e bordit të revistës që janë edhe personalitete të shquara në universitete të huaja.

CIT Review është revistë shkencore me disa parametra ku dallohen qartësisht:

- Reviste me Open Access;
- Vizibilitet në databazat e revistave shkencore;
- Bord editorial dhe bashkëpunëtorësh ndërkombëtar ku spikasin emra të njohur të botës akademike e shkencore;
- Revistë me proces Peer-Review;
- Pjesë e databazës Ulrichsweb™ Periodicals Directory;
- Indeksuar në Citefactor.

Në këtë revistë janë publikuar mbi 50 artikuj shkencorë, na të cilët artikujt e publikuar prej stafit akademik të institucionit kanë qenë pa pagesë. Politika e publikimit të artikujve shkencorë

pa pagesë të stafit akademik të të dy fakulteteve është një incitivë që jo vetëm t’i mbështesi ata në kualifikimet e tyre pasuniversitare por dhe t’i ndihmojë që puna e tyre shkecore të marrë vlerën dhe rëndësinë e duhur duke qenë se revista ka ISSN, si dhe është e indeksuar në Citefactor. Përpjekje të vazhdueshme po bëhen që revista të bëhet pjesë edhe e indeksimeve të tjera si ai Ulrich Periodical Directory, etj.

PROGRAMET E STUDIMIT

d.) Të dhëna mbi programet e studimit

i) IAL-ja informon mbi të gjitha programet e studimit që ofron, përfshirë ato ndërdisiplinore dhe të përbashkëta, nëse ka. Në raport paraqiten programet e studimit që janë aktive, të pezulluara, të mbyllura, për të cilën/cilat është marrë leje për hapjen e tij/tyre, por nuk është aktivizuar.

KU “IKT” ofron programe studimi të organizuara në dy fakultete, në atë të Inxhinierisë dhe atë të Ekonomisë. Secili prej tyre organizohet në njësi bazë dhe njësi të kërkimit shkencor. Programet e studimeve organizohen sipas sistemit 3 + 2 të Kartës së Bolonjës. Programet e studimeve të ciklit të parë (Bachelor) zgjasin 3 vite (180 ECTS), ndërsa ato të ciklit të dytë (Master i Shkencave) zgjasin dy vjet (120 ECTS).

Gjatë vitit 2020-2021, KU “IKT” ka vijuar zhvillimin e procesit mësimor në dy fakultetet dhe programet që ka pasur aktiv. Statuti, Rregullorja Institucionale dhe “Libri i rregulloreve të institucionit” përcaktojnë detyrat, funksionet, përgjegjësitë dhe procesin e vendimmarrjes.

Secili prej fakulteteve gjatë këtij viti akademik ka ofruar programet e studimit si më poshtë:

FAKULTETI I EKONOMISË:

- a. *Në ciklin e parë të studimeve, për diplomën*
“Bachelor në Administrim Biznesi”;
“Bachelor në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni”;
“Bachelor në Financë dhe Kontabilitet”.
- b. *Në ciklin e dytë të studimeve, për diplomën*
“Master i Shkencave në Administrim Biznesi”;
“Master i Shkencave në Financë dhe Kontabilitet” (me dy profile).

FAKULTETI I INXHINIERISË:

- c. *Në ciklin e parë të studimeve, për diplomën*
“Bachelor në Inxhinieri Softuerike”;
“Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni”;
“Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni”.
- d. *Në ciklin e dytë të studimeve, për diplomën*
“Master i Shkencave në Inxhinieri Softuerike”

“Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni” (me tre profile).

KU “Instituti Kanadez i Teknologjisë” ofron programe studimi në dy cikle. Në ciklin e parë Bachelor dhe në atë të dytë Master i Shkencave. Në ciklin e parë të studimit në vitin akademik 2020-2021 janë ofruar gjithsej 6 programe në të dy fakultetet, ndërsa në ciklin e dytë të studimit ofrohen 4 programe në të dy fakultetet.

Forma e studimit në “Institutin Kanadez të Teknologjisë” është ajo me kohë të plotë.

Të gjitha departamentet përbëhen më së paku nga të paktën 7 akademikë të punësuar me kohë të plotë, prej të cilëve të paktën tre kanë gradë ose titull.

Përsa i përket programit Master i Shkencave në “Inxhinieri Telekomunikacioni”, përmes Urdhërit Nr. 348 të MASR, datë 17.09.2021, ky program u konsiderua i mbyllur për shkak të mos regjistrimit të studentëve në dy vite konsektive. Kësisoj për vitin 2020-2021 ky program u konsiderua i mbyllur dhe po ashtu u zbatuan dhe procedurat në sistemin eAlbania për mbylljen e tij.

Programet e Studimit dhe Diplomat

Veprimtaria mësimore në KU “IKT” gjatë vitit akademik 2020-2021 është realizuar në 10 (dhjetë) programe studimi: 5 (pesë) në **Fakultetin e Ekonomisë**; dhe 5 (pesë) në **Fakultetin e Inxhinierisë**.

Institucioni synon që ofrimi i këtyre programeve të plotësojë nevojat e studentëve që mbarojnë ciklin e parë pranë KU “IKT” dhe të vazhdojnë studimet e tyre në ciklin e dytë pranë të njëjtit institucion.

Programet e studimit jepen sipas tabelës më poshtë e cila përshkruan njësinë kryesore, emertimin e programit dhe ciklin e tij të studimit, për vitin 2020-2021 dhe ato për vitin e ardhshëm 2021-2022.

Nr.	Fakulteti/Cikli	<i>10 Programe studimi në dy cikle, zhvilluar në Vitin Akademik 2020-2021</i>	<i>12 Programe studimi në dy cikle për Vitin Akademik 2021-2022</i>
FAKULTETI I EKONOMISË			
1.	Cikli i Parë i Studimeve (Bachelor)	“Bachelor” në: 1. Administrim Biznesi; 2. Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni”; 3. Financë dhe Kontabilitet.	“Bachelor” në: 1. Administrim Biznesi; 2. Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni”; 3. Financë dhe Kontabilitet.
2.	Cikli i Dytë i Studimeve (Master i Shkencave)	“Master i Shkencave” në: 1. Administrim Biznesi; 2. Financë dhe Kontabilitet, me profile:	“Master i Shkencave” në: 1. Administrim Biznesi; 2. Financë dhe Kontabilitet, me profile:

		a. Financë dhe Bankë b. Kontabilitet dhe Auditim	a. Financë dhe Bankë b. Kontabilitet dhe Auditim 3. Teknologji Informacioni në Biznes; 4. Marketing Digjital.
FAKULTETI I INXHINIERISË			
1.	Cikli i Parë i Studimeve (Bachelor)	“Bachelor” në: 1. Inxhinieri Softuerike; 2. Inxhinieri Telekomunikacioni; 3. Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni.	“Bachelor” në: 1. Inxhinieri Softuerike; 2. Inxhinieri Telekomunikacioni; 3. Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni.
2.	Cikli i Dytë i Studimeve (Master i Shkencave)	“Master i Shkencave” në: 1. Inxhinieri Softuerike; 2. Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni” me profile: a. Inxhinieri Kompjuterike dhe Big Data b. Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike c. Multimedia-Dizajn	“Master i Shkencave” në: 1. Inxhinieri Softuerike; 2. Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni” me profile: a. Inxhinieri Kompjuterike dhe Big Data b. Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike c. Multimedia-Dizajn
3	Program i Formimit të Vazhduar	“Auditim Energjie”	“Auditim Energjie”

Tab. nr. 4: Programe Studimi dhe Diploma në Institutin Kanadez të Teknologjisë

ii) IAL-ja informon mbi marrjen e lejes për hapjen e programit të studimit që është në process vlerësimi, si dhe për programe që ofrojnë formim të vazhdueshëm për të tretë apo për zhvillimin profesional të personelit të tyre. Këto të dhëna shoqërohen me numrin dhe datën e aktit për hapjen, për pezullimin ose për mbylljen e programit të studimit.

Aplikimi për katër programe të reja në të dy ciklet

Në dhjetor të vitit 2020, IKT aplikoi për hapjen e katër programeve të reja, përkatësisht atyre në:

FAKULTETI I INXHINIERISË

Departamenti i Inxhinierisë Softuerike

-Bachelor në «Data Science dhe Inteligjencë Artificiale» (180 ECTS)

Departamenti i Inxhinierisë Industriale

-Master i Shkencave në «Inxhinieri Telekomunikacioni» (120 ECTS)

FAKULTETI I EKONOMISË

Departamenti i Administrimit Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit

-Master i Shkencave në «Teknologji Informacioni në Biznes» (120 ECTS)

-Master i Shkencave në «Marketing Digjital» (120 ECTS)

Prej këtyre programeve u licensuan vetëm dy programet e kërkura prej Fakultetit të Ekonomisë, Departamentit të Administrim Biznesit dhe IT: Përmes Urdhërit nr. 345, të MASR datë 17.09.2021 për licensimin e programit Master i Shkencave në “Marketing Digjital”, në gjuhën angleze, me kohë të plotë; si dhe Urdhërit nr. 359 të MASR, datë 17.09.2021, për licensimin e programit Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni në Biznes”, në gjuhën angleze, me kohë të plotë.

Programet e licensuara:

-Master i Shkencave në «Teknologji Informacioni në Biznes» (120 ECTS)

-Master i Shkencave në «Marketing Digjital» (120 ECTS)

Këto programe filluan të regjistrojnë studentë për herë të parë në vitin aktual akademik 2021-2022.

Në shkurt të vitit 2021, IKT, dorëzoi në MASR disa ndryshime, deri në masën 20% për programet e studimit: Bachelor në Inxhinieri Softuerike, Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni dhe Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike dhe IT, si dhe Master i Shkencave në Administrim Biznesi. Kurrikulat e ndryshuara u aplikuan gjatë këtij viti akademik.

iii) Përshtatshmëria e programeve të studimit me misionin e institucionit, realizimin e synimeve të programit të studimit nga ana e përmbajtjes dhe lidhjen e rëndësishme e programeve të studimit nisur nga vlerësimi i nevojave për aftësi në tregun e punës.

IKT ka synuar dhe vazhdon ta mbështes synimin për të qenë një institucion i “orjentuar drejt projekteve”, pra që studentët të mësojnë dhe praktikojnë aftësitë e tyre përmes projekteve, qofshin ato individuale ose në grup. Bazuar dhe në objektivat e institucionit si dhe në ato të njësive kryesore, të përmendura në fillim të raportit, secila prej lëndëve synon që të ketë një projekt në përfundim të saj të realizuar nga studentët.

Të gjitha programet që ofron KU “IKT” janë në përshtatje me misionin, vizionin e institucionit si dhe objektivat e vendosur. Përshtatshmëria e tyre analizohet prej njësive kryesore dhe në rast të ndryshimeve të hetuara e të para si të domosdoshme, merren masa për të kryer përditësimet dhe përshtatjen e këtyre programeve. Gjithashtu programet e lëndës (silabuset), të kurrikulave përkatëse, pasurohen dhe përditësohen duke reflektuar një literaturë bashkëkohore si dhe përfshijnë aftësi (*skills*) të cilat mbështesin përparimin e studentëve drejt nevojave të tregut. Mësimdhënia në gjuhën angleze u jep mundësi studentëve që të përgatiten jo vetëm për tregun brenda vendit, por edhe përtej tij. Në të njëjtën kohë ata kanë mundësi të ndjekin specializime të tjera në universitete të njohura ndërkombëtarisht.

e) Ndryshimet në Statutin apo Rregulloret e IAL-së, si dhe të dhëna për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

➤ *Ndryshimet statutores*

KU “IKT” nuk ka pasur ndryshime statutores për vitin akademik 2020-2021.

➤ *Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë*

Prej vitit 2014 e në vazhdim institucioni ka të ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila funksionin bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin e Institucionit, Rregulloret specifike si dhe Manualin e Sigurimit të Cilësisë.

Siç vërehet prej tabelës nr.5, Njësia përbëhet nga një staf me eksperiencë në sigurimin e cilësisë, i cili prej vitesh bashkëpunon dhe orienton punën drejt cilësisë së edukimit. Ky staf ka vijuar të mbetet i pa ndryshuar duke qënë se në themel vetë sigurimi i cilësisë ka si premisë bazë, përmirësimin e vazhdueshëm dhe stabilitetin e hallkave, ndërveprimin, ekosistemeve administrative si dhe atyre akademike.

NjSBC dhe anëtarët

	Anëtarët e NJSBC	Detyra që kanë në NJSBC	Sa kohë ka në këtë detyrë
1.	Dr. Bledar Komina	<i>Kryetar</i>	7.5 vjet
2.	PhD. Dorian Jano / MSc.Julian Saraçi	<i>Anëtar</i>	1 vit / 6 muaj
3.	PhD Afrim Alimeti	<i>Anëtar/Fakulteti i Inxhinierisë</i>	5 vjet
4.	Prof.as. Artur Jaupaj	<i>Anëtar/Fakulteti i Ekonomisë</i>	5 vjet
5.	Denis Xheleku	<i>Student</i>	1.5 vite

Tabela nr. 5: Të dhëna për anëtarët e NJSBC-së së IKT.

Gjatë vitit akademik 2020-2021 janë zbatuar të gjitha procedurat e përcaktuara në aktet e përmendura më sipër, dhe në të njëjtën kohë njësia ka punuar mbi punimin ose përmirësimin e rregulloreve, udhëzimeve dhe manualëve që u vijnë në ndihmë institucionit, stafit akademik dhe administrative si dhe studentëve.

Dokumentacioni mbi të cilin e mbështet punën e vet Njësia bazohet mbi:

1. Statutin dhe Rregulloren Institucionale;
2. Manualin e Sigurimit të Cilësisë (QAU Handbook);
3. Rregulloren “Mbi organizimin e NJSBC” (Libri i Rregulloreve Institucionale, fq. 26-27);
4. Rregulloren “Mbi procedurat për mbështetjen dhe përmirësimin e programeve të studimit” (Libri i Rregulloreve Institucionale, fq. 28-32).

Përveç këtyre janë edhe një sërë rregulloresh të tjera, të cilat kontribuojnë në sigurimin dhe ruajtjen e cilësisë në institucion.

Sipas rregullores “Mbi procedurat për mbështetjen dhe përmirësimin e programeve të studimit”, NJSBC, në bashkëpunim me njësitë kryesore dhe ato bazë, kanë përgjegjësinë kryesore për mbarëvajtjen dhe rritjen e cilësisë në institucion.

Detyrat kryesore të NJSBC

Në përmbushje të pikave të mësipërme, NJSBC bashkë me fakultetet dhe departamentet organizojnë “Pyetësorët e studentëve” për secilin program dhe lëndë; marrjen e informacionit, përmes pyetësorëve mbi ecurinë e institucionit; vlerësimin e stafit akademik, përmes procesit të

Vetë-vlerësimi; si dhe vlerësimin e programeve prej njësave bazë. Gjatë këtij procesi studentët janë të përfshirë, si brenda NJSBC, pra si organizatorë, ashtu si dhe aktorë përgjatë vlerësimit të pedagogëve për secilën lëndë.

I gjithë informacioni që ka të bëjë me metodologjinë e vlerësimit dhe instrumentet matëse për ecurinë e programeve të studimit, përfshihet në vlerësimin institucional, ose atë të NJSBC. Metodologjia e vlerësimit mbështetet mbi vetë-deklarimin. Ndërsa instrumentët për ta arritur këtë gjë kanë qenë pyetësorët në rastin e studentëve dhe në rastin e stafit akademik e administrativ, vetë-vlerësimi. Përmes raportimit, vetë-vlerësimit dhe pyetësorëve të kryer janë marrë të dhëna të rëndësishme mbi ecurinë e proceseve brenda institucionit.

Kontrolli realizohet nëpërmjet vlerësimit periodik nga vetë studentët në fund të çdo semestri, përmes disa pyetësorëve, si dhe vetë-vlerësimit të performancës nga çdo pedagog; vlerësimit prej eprorëve respektivë të punës së realizuar nga pedagogët dhe vlerësimit “administrativ” për aspekte të tilla, si respektimi i orarit, niveli i shfrytëzimit të orës së mësimi, respektimi i afateve, korrektesa e çdo pedagogu në plotësimin e dokumentacionit përkatës, etj.

Organizimi i pyetësorëve dhe anketimeve për stafin dhe studentët

Gjatë këtyre viteve janë organizuar pothuajse çdo semestër pyetësorë në lidhje me organizimin e programeve, pedagogët dhe lëndët që ata japin, përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, në lidhje me literaturën e përdorur nga stafi akademik, etj. Pyetësorët kanë qenë anonim dhe të zhvilluar online. Të dhënat janë përpunuar dhe i janë dorëzuar instancave përgjegjëse me synim përmirësimin e cilësisë, rritjen e zbatimit të standardeve të kërkuara si dhe arritjes së objektivave të institucionit. KU “IKT”, rezultatet e përfuara i shikon si një mënyrë për të përmirësuar veten dhe marrëdhëniet me studentët. Një aspekt i rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies është trajnimi i stafit akademik të IKT në fushën e cilësisë së edukim, ku trajnime të ndryshme mbi këtë fushë janë kryer prej NJSBC dhe Rektoratit.

Kryesisht pyetësorët e zhvilluar në këto vite akademike janë përqëndruar në vlerësimin e këtyre aspekteve:

- Vlerësimin e stafit nga studentët;
- Vlerësimin e studentëve për programet dhe lëndët;
- Vlerësimin e studentëve për literaturën e përdorur;
- Vlerësim mbi pritshmëritë që kanë studentët ndaj institucionit.

- Në total janë 2 pyetësor dhe 1 anketim të realizuar nga institucioni (NJSBC) për vitin akademik 2020-2021;
- Nga këto 2 pyetësorë janë organizuar me fokus përmbajtjen dhe zbatimin e programit të lëndës si dhe cilësinë e mësimdhënies;
- Anketimi është organizuar lidhur me ecurinë e mësimi online si dhe zhvillimin e provimeve.
- Gjithashtu është zhvilluar edhe procesi i vetvlerësimit të stafit akademik dhe atij administrativ sipas modeleve përkatëse.

Raportet e detajuara mbi rezultatet e pyetësorëve u dërgohen Rektoratit dhe më pas dekanëve, të cilët ndjekin dhe analizojnë me kujdes rezultatet e përfuara prej pyetësorëve. Në varësi të

rezultateve ndërtohen dhe pritshmëritë si dhe veprimtaria e rektoratit dhe dekanëve për pedagogët që mund të mos kenë pasur një performancë të pëlqyeshme. Megjithatë pyetësorët janë vetëm një pjesë e vlerësimit të pedagogëve, kjo pasi pedagogët përveç vlerësimit nga studentët, zhvillojnë edhe procesin e vetvlerësimit. Të gjitha raportet e vetvlerësimit bashkë me të dhënat e pyetësorëve ndërtojnë panoramën e situatës brenda institucionit mbi procesin e mësimdhënies, funksionimit të njësisë bazë, kërkimit shkencor si dhe kontributit për çështje administrative nga ana e stafit akademik.

NjSBC ka kontribuar edhe në organizimin, zhvillimin dhe mbarëvajtjen e procesit të akreditimit të programeve:

- Bachelor në Inxhinieri Kopjuterike dhe IT dhe
- Bachelor në Financë dhe Kontabilitet

Njëkohësisht NjSBC ka kryer edhe vlerësimin e kurrikulave mësimore prej ekspertëve të jashtëm të angazhuar nga vet institucioni, për të analizuar programet mësimore, lëndët si dhe përshtatjen e tyre me tregun e punës.

f) Angazhimi i personelit akademik, ngarkesa përkatëse, lëndën/t, dhe/ose moduln/et që do të zhvillojë secili prej tyre për secilin semestër të vitit akademik

**Të dhënat mbi angazhimin e stafit akademik për vitin 2019-2020, ngarkesën si dhe shpërndarjen e lëndëve jepen në Shtojcën e këtij raporti.*

i) Përqindjen e të diplomuarve që kalojnë provimin e shtetit dhe licencohen, kur programi i studimit ka lidhje me një profesion të rregulluar.

**Programet që ofron KU “IKT” nuk janë të lidhura me licensa ose me profesione të rregulluara.*

h) Të dhëna për këshillat studentorë dhe përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të IAL-së dhe në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

Përbërja e Qeverisë Studentore 2020-2021:

- Klejsi Dogjani – Presidente e Qeverisë Studentore
- Brendon Pojani – Zv. President
- Adela Lamce – Sekretare e Qeverisë Studentore

Komisioni i Bursave

- Kamila Hyka - student

Komiteti i Shëndetit dhe Sigurisë

- Klaudja Mersini – student

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

- Odeta Sipri- student

Komisioni i Përhershëm për Kërkimin Shkencor, Projektet, Aplikimet dhe Inovacionin

- Uendi Nelku – Student

Komisioni i Përhershëm për Kurrikulat dhe Programet Mësimore

- Arber Gjonaj – student

Komisioni i Përhershëm për Marrëdhëniet me Studentët dhe Garantimin e të Drejtave Studentore

- Adela Lamçe – student
- Anisa Zaçe – student

Këshilli i Etikës

- Klejsi Dogjani - student


i) Vlerësime të IAL-së dhe rekomandime të mundshme për ministrinë

KU “IKT” thekson se, vlerësimi i përgjithshëm për komunikimin me këtë ministri mbetet pozitiv, korrekt dhe kurdoherë institucional. KU “IKT” vijon të vlerësojë maksimalisht punën dhe angazhimin e ndërmarrë prej Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë gjatë vitit akademik 2020-2021.


BORDI I ADMINISTRIMIT

Struktura organizative, miratuar prej MASR me Statutin e institucionit


ORGANIZATIONAL CHART



ORGANIZATIONAL CHART - FACULTY OF ECONOMY STRUKTURA ORGANIZATIVE - FAKULTETI I EKONOMISE



ORGANIZATIONAL CHART - FACULTY OF ENGINEERING STRUKTURA ORGANIZATIVE - FAKULTETI I INXHINIERISE



a) Të dhëna të përgjithshme mbi IAL-në lidhur me strukturën e përgjithshme organizative të institucionit të arsimit të lartë, njësitë përbërëse dhe autoritetet drejtuese përkatëse etj.

a. Titullarët e Institucionit, Njësive dhe Departamenteve

KU “IKT” siç është theksuar edhe në hyrje të këtij raporti, ka funksionuar në të gjitha hallkat dhe hierarkinë e vet institucionale, duke nisur prej organeve vendimmarrëse, tek ato kolegjiale, autoritetet ekzekutive, këshillat dhe komitetet, si dhe duke zbritur në instancat administrative zbatuese. Institucioni ka zhvilluar mbledhje periodike si ato në Senatën Akademik, Këshillat e Fakulteteve, komisionet dhe komitetet e ndryshme janë mbledhur si online ashtu dhe në institucion duke respektuar normat e shëndetit dhe ato në rast pandemie.

Një mbështetje e madhe i është dhënë edhe jetës studentore si dhe mbështetjes së Qeverisë Studentore për të funksionuar si një organ i pavarur dhe që përfaqëson interesat dhe kërkesat e studentëve brenda institucionit.

Për vitin akademik 2020-2021 Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” ka pasur një strukturë të plotë në rang administrativ, administrativo-akademik, akademik mësimdhënës si dhe kërkuesish shkencor, përmes së cilës ka përmbushur objektivat vjetor institucional dhe ato të njësive kryesore, si dhe ka vijuar punën për të kontribuar në zhvillimin e tërësishëm të institucionit.

FUNKSIONI	TITULLARI
<i>Rektor</i>	Prof.Dr. Sokol Abazi
<i>Zv.Rektor</i>	Prof.Assoc. Vaso Qano Prof.Assoc. Reis Mulita
<i>Dekan i Fakultetit të Inxhinierisë</i>	Prof.Assoc. Abdusalam Al-Khoulidi/Prof.Dr. Margarita Ifti
<i>Përgjegjës i Departamentit të Inxhinierisë Softuerike</i>	Dr. Adriola Faqolli
<i>Përgjegjës i Departamentit të Inxhinierisë Industriale</i>	Dr. Afrim Alimeti/Dr. Alfons Harizaj
<i>Përgjegjës i Njesisë së Kërkimit Shkencor “CIRD Inxhinieri”</i>	Dr. Miranda Deda
<i>Dekan i Fakultetit të Ekonomisë</i>	Prof.Assoc. Artur Jaupaj
<i>Përgjegjës i Departamentit Administrim Biznesit</i>	Dr. Edmira Cakrani
<i>Përgjegjës i Departamentit Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni</i>	Dr. Blendi Shima
<i>Përgjegjës i Njesisë së Kërkimit Shkencor “CIRD Ekonomi”</i>	Dr. Jona Puci
<i>Administrator</i>	Esmā Selmani
<i>Kryesekretare</i>	Kostanca Kasapi/Antigona Lazaj

Tab. Nr. 13: Titullarë dhe funksionarë të institucionit.

Sipas statutit dhe rregulloreve të institucionit, politikën kryesore të zhvillimit dhe rekomandimet me karakter strategjik në nivel institucional e realizon Bordi i Administrimit i cili bashkërendon punën e tij me Senatën Akademik, ndërsa në nivel fakulteti e realizon Këshilli i

Fakultetit dhe Dekanati si organe bazë vendimmarrës e këshillues. Drejtimi dhe vendimmarrja realizohet tërësisht nga autoritetet drejtuese si Rektori, Dekani, Përgjegjësit e Departamenteve, të cilët kryejnë plotësisht punën e tyre, sipas Ligjit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor në Republikën e Shqipërisë dhe udhëzimeve të MASR. Senati Akademik i institucionit ka qenë organi vendimmarrës kolegjial akademik i cili ka marrë vendimet kryesore për zhvillimin e jetës akademike duke pasur si shtytje e për bazë propozimet nga njësitë kryesore e ato më poshtë.

Iniciativat e Senatit Akademik përfshijnë, dhe jo vetëm, një sërë vendimesh duke filluar që nga miratimi rregulloreve institucionale, manualëve, strukturës kalendarike vjetore, aplikimit për projekte si dhe për hapjen e programeve të reja, miratimin e planeve mësimore, rregulloreve mësimore të rishikuara, kuotat sipas programeve, ngarkesën akademike vjetore, miratimin e objektivave vjetorë, anëtarësive në këshillat dhe organet kolegjiale (komitete) etj.

Vendimet e marra prej Senatit Akademik janë mbështetur në nevojat institucionale, detyrimet ligjore si dhe në veprimtarinë e përditshme e atë me bazë binomin student-pedagog. Këshillat e Fakulteteve, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, apo komitetet e tjera akademike e jo vetëm, janë përkushtuar në mirëfunksionimin e tyre si dhe efektshmërinë ndaj objektivave vjetorë dhe qëllimeve të institucionit për t'i realizuar ato sa më mirë.

b. Bordi i Administrimit

Bordi i Administrimit të KU “IKT” deri në prill të vitit 2021 është përbërë nga:

Nr.	Emër Mbiemër	Pozita
1.	Prof.Assoc. Ramiz Zekaj	Kryetar
2.	Prof.Dr. Merita Xhumari	Anëtare
3.	Prof.Dr. Shkëlqim Cani	Anëtar
4.	Prof.Dr. Llukan Puka	Anëtar
5.	Prof.Dr. Andonaq Lamani	Anëtar

Tab. 14/1: Bordi i Administrimit të KU “IKT”

Pas prillit të vitit 2021 e deri në përfundim të vitit akademik, përbërja e tij ka qenë:

Nr.	Emër Mbiemër	Pozita
1.	Prof.Assoc. Ramiz Zekaj	Kryetar
2.	Prof.Dr. Elez Osmanoviç	Anëtar
3.	Prof.Dr. Shkëlqim Cani	Anëtar
4.	Prof.Assoc. Fabian Zhilla	Anëtar
5.	Dr. Gazmend Pula	Anëtar

Tab. 14/2: Bordi i Administrimit të KU “IKT”

e) Të dhëna mbi mobilitetin e personelit akademik të financuara nga IAL-ja apo të realizuara në kuadër të projekteve ndërkombëtare

Shënim nr. 1: Të dhënat për mobilitetin e stafit akademik dhe të studentëve janë përmendur në faqen 47 të këtij raporti.

Shënim nr. 2: Ndërsa të dhënat lidhur me aplikimet për projekte janë përfshirë në Tab. nr. 3: Aplikimet për projekte 2020-2021, fq. 30-31 e këtij raporti.

f) Të dhëna për plotësimin e standardeve shtetërore akademike dhe infrastrukturore, në përputhje me Kodin e Cilësisë, ku përfshihen ndryshime në mjediset didaktike, kërkimore, politika të shpërndarjes së fondeve në funksion të përmirësimit të cilësisë, numri i teksteve dhe infrastruktura informatike në funksion të mësimin, në bashkëpunim me Senatin Akademik të institucionit të arsimit të lartë

- i) *Të dhëna për plotësimin e standardeve shtetërore akademike dhe infrastrukturore, në përputhje me Kodin e Cilësisë, ku përfshihen ndryshime në mjediset didaktike, kërkimore, politika të shpërndarjes së fondeve në funksion të përmirësimit të cilësisë*

Infrastruktura në shërbim të kërkimit shkencor për stafin dhe studentët

Kolegji Universitar “IKT” dëshmon se, nisur edhe nga numri i studentëve, ka sasi të mjaftueshme të laboratorëve, klasave, zyrave, studiove dhe mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimit. Klasat janë të gjitha të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike, duke filluar nga kompjuterat (në të cilat janë të instaluar të gjitha softet që kërkon programi i studimit), projektorë, tabela shënimesh, etj.

KU “IKT” ofron fasilite të mësimore të ndërtuara me materiale bashkëkohore me cilësi të lartë, të cilat plotësojnë kushtet higjienike dhe sanitare për studentët dhe stafin akademik dhe administrativ, duke shmangur materialet e rrezikshme. Procesi mësimor zhvillohet në kushte shumë të përshtatshme të parametrave fizikë (temperatura, ndriçimi, lagështira, drita etj). Me të njëjtën cilësi të parametrave fizikë, si dhe me një sipërfaqe të konsiderueshme ofrohen ambientet e zyrave për stafin drejtues administrativ dhe atë akademik. Fasilitetet e IKT kanë akustikë të shkëlqyeshme dhe janë të izoluar nga zhurma dhe ndotja akustike, si dhe luhatjet e temperaturës dhe lagështisë.

Në total KU “IKT” ka 5 laboratorë, 6 klasa, 1 sallë konferencash, 1 sallë takimesh dhe 1 bibliotekë më 20 poste në funksion të procesit mësimor si dhe salla, zyra dhe ambiente të tjera në shërbim të këtij procesi.

Institucioni disponon Aktin Kundër Zjarrit me Nr. Prot. C-10325/1, datë 24.05.2021 dhe Aktin Higjieno Sanitar Nr. 171, datë 24.05.2021.

KU “IKT” ofron një sipërfaqe totale prej 2715 m². Nga këto, 2385 m² janë ambiente në shërbim të procesit mësimor dhe 330 m² janë parkim. Prej këtyre ambienteve 1430 m² janë në katin e parë dhe 955 m² janë në katin e dytë të institucionit. Institucioni në shërbim të procesit mësimor ka 5 laboratorë, 1 sallë konferencash, 6 klasa, 1 bibliotekë, një sallë mbledhjesh e takimesh, si dhe zyra ndihmëse administrative e akademike për stafin, ajo për pritjet, sekretaritë, kryesekretaria, sallë pedagogësh nga një për secilin fakultet etj.

Mjediset e sallave të mësimit, laboratorët, zyrat dhe shërbime të tjera, janë të një standarti të lartë dhe të pajisura me të gjithë infrastrukturën e nevojshme, jo vetëm për zhvillimin komod dhe me standarte të procesit mësimit, por edhe me facilitete dhe përfitime, si për studentët, ashtu edhe për stafin akademik. Për qëllime të organizimit të aktiviteteve shkencore, (konferenca, seminare, leksione të hapura, tryeza të rrumbullakta, etj), sociale dhe kulturore, Institucioni, Fakultetet dhe Departamentet, shfrytëzojnë sallën e konferencave, e cila ka një sipërfaqe prej 200 m², me kapacitet 170-180 personash. Në shërbim të pritjeve dhe aktiviteteve të ndryshme është projektuar edhe kafeteria, që ka një hapësirë prej rreth 185m².

Të gjithë laboratorët e informatikës janë të pajisura me programet (softuer) e duhur për mbarëvajtjen e procesit mësimit. Çdo kompjuter ka dual boot option. Sistemet e operimit janë Windos (10) dhe Linux (Ubuntu 14.04). Çdo kompjuter i laboratorit ka të instaluar paketën Office Professional 2010 ose 2013 (Word, Excel, Access, Power Point, Outlook etj.). Gjithashtu janë të instaluar programet profesionale si: MS SQL Server 2014; Microsoft Visual Studio 2015; NetBeans 8.2; Octave; Wireshark; Bizagi Modeler & Express; Wamp Server, etj.

Të gjitha programet e instaluar janë të licensuara në bazë të kontratës me *Microsoft Academy* ose janë free. IKT është një nga të paktët IAL, që kanë blerë licensat që përdoren nga studentët e pedagogët.

Të gjithë laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin sa më modern të procesit mësimit. Instalimi, mirëmbajtja dhe azhurnimi i pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i departamentit të IT. Instalimet e programeve të reja bëhen në kohë reale në bazë të kërkesave të pedagogëve.

Në shërbim të studentëve janë 5 laboratorë.

Përkatësisht:

Tab. Nr. 17: Infrastruktura laboratorike

Emërtimi	Pajisje PC	Projektor	Të tjera
LAB 1	Përmban 48 kompjutera	1 video projektor	
LAB 2	Përmban 48 kompjutera	1 video projektor	
LAB 3	Përmban 46 kompjutera	1 video projektor	
LAB 4	Përmban 45 kompjutera	1 video projektor	Hub për inkubim start up-esh
LAB 5	Përmban 40 kompjutera	1 video projektor	Përmban dhe pajisje telekomi

Të gjitha programet kompjuterike të instaluar i përshtaten programeve mësimore nëpërmjet instalimit të aplikacioneve, që kërkohen nga departamentet përkatëse

Kompjuterat kanë të instaluar një antivirus, Microsoft Security Essentials, i cili mundëson sigurimin e dokumenteve dhe të dhënave të tjera prej infektimit nga viruse të ndryshme.

Laboratorët mund të aksesohen në çdo moment gjatë gjithë javës (e hënë – shtunë) nga ora 9:00 deri në 21:00.

Mësimi në Kolegjin Universitar “IKT”, zhvillohet gjatë gjithë ditës, nga ora 09.00-21.00. Alternimi i orarit, sipas ciklit të studimeve, por edhe programeve e rrit edhe më tepër mundësinë e shfrytëzimit të klasave, laboratorëve, zyrave dhe mjediseve të tjera.

Mjediset mësimore të Kolegjit Universitar “IKT” janë shumë të përshtatshme për mësimdhënie dhe plotësojnë kërkesat e programit.

Tab. Nr. 18: Infrastruktura institucionale

INFRASTRUKTURA INSTITUCIONALE		
MJEDISET	SASIA	SIPËRFAQJA
KATI I PARË		
Laboratorë për lëndët	5	447 m ²
Arkiva	1	25 m ²
Bar-kafe, oborr i brendshëm, për aktivitete sociale, kulturore dhe rekreative	1	165 m ²
Sallë konferencash	1	200 m ²
Zyrë IT	1	20 m ²
Server	1	12 m ²
Korridore	-	215 m ²
Tualete per studentet	10	40 m ²
Oborr i brendshëm me gjelbërim		95 m ²
Zyra për marketing, financë, burime njerëzore etj	3	35 m ²
Holl kryesor, reception sallë pritje	1	40 m ²
Sekretari fakultetesh, kryesekretari	3	63 m ²
Nyje hidrosanitare për stafin	2	18 m ²
Nyje hidrosanitare për person me nevoja të veçanta	1	4 m ²
Zyra për përgjegjësit e departamenteve	3	60 m ²
TOTAL KATI 1		1430 m²
KATI I DYTË		
	SASIA	SIPËRFAQJA
Klasa për leksione, seminare dhe ushtrime	6	331 m ²
Sallë pedagogësh I	1	50 m ²
Sallë pedagogësh II	1	60 m ²
Zyrë administratori	1	26 m ²
Sekretari administratori	1	16 m ²
Zyrë dekani	2	40 m ²
Zyrë rektori	1	35 m ²
Asistent rektori	1	8 m ²
NJSBC dhe Zyra për Shërbim ndaj Studentëve	1	14 m ²
Zv.rektor	1	12 m ²
Sallë mbledhjesh	1	40 m ²
Biblioteka	1	90 m ²
Sanitaret	1	8 m ²
Korridore	-	100 m ²
Tualete stafi dhe sutudentët	15	60 m ²
Verandë	-	60 m ²
Parkim		330 m ²
TOTAL KATI 2		1285 m²
TOTALI INSTITUCIONAL		2715 m²

Tab. Nr. 19: Në funksion dhe shërbim të procesit mësimor

NË FUNKSION DHE SHËRBIM TË PROCESIT MËSIMOR		
MJEDISET	SASIA	SIPËRFAQJA
KATI I PARË		
Laboratorë për lëndët	5	447 m ²
Arkiva	1	25 m ²
Sallë konferencash	1	200 m ²
Zyrë IT	1	20 m ²
Server	1	12 m ²
Sekretari fakultetesh, kryesekretari	3	63 m ²
Zyra për përgjegjësit e departamenteve	3	60 m ²
TOTAL KATI 1		827 m²
KATI I DYTË		
Klasa për leksione, seminare dhe ushtrime	6	331 m ²
Sallë pedagogësh I	1	50 m ²
Sallë pedagogësh II	1	60 m ²
Zyrë administratori	1	26 m ²
Sekretari administratori	1	16 m ²
Zyrë dekani	2	40 m ²
Zyrë rektori	1	35 m ²
Asistent rektori	1	8 m ²
NJSBC dhe Zyra për Shërbim ndaj Studentëve	1	14 m ²
Zv.rektor	1	12 m ²
Sallë mbledhjesh	1	40 m ²
Biblioteka	1	90 m ²
Bar-kafe, oborr i brendshëm, për aktivitete sociale, kulturore dhe rekreative	1	165 m ²
TOTAL KATI 2		887 m²
TOTALI INSTITUCIONAL		1714 m²

Kapaciteti i sallave (klasave, laboratoreve) ku zhvillohet mësimdhënia varion nga 30-35 studentë në ato me 50-60, dhe me 180 studentë.

KU “IKT” i kushton një rëndësi shumë të madhe teknologjisë, cilësisë së laboratorëve, por edhe programeve kompjuterike, të cilat shfrytëzohen për module apo lëndë të ndryshme. Shumë prej lëndëve/moduleve i japin një peshë të madhe realizimit të projektit nga ana e studentit, të cilët në çdo orë të ditës mund të shfrytëzojnë laboratorët si dhe programet e instaluar në këto laboratorë, për realizimin e projekteve dhe detyrave të caktuara.

KU “IKT”, në periudha të ndryshme brenda vitit akademik, ose gjatë pushimeve dimërore kryen edhe dezinfektimin e institucionit, proces që kryhet nga kompani profesionale, të cilat kanë vite që operojnë në treg.

Biblioteka dhe fondet në ndihmë të kërkimit shkencor

KU “IKT” vë në dispozicion të studentëve të saj, por edhe të komunitetit një bibliotekë shumë të pasur. Biblioteka ka një fond të pasur me libra në fushat e Inxhinierisë dhe Ekonomisë, si dhe në fushat ku është përqëndruar dhe aktiviteti i KU “IKT”, siç janë: shkencat ekzakte (matematika, statistika, fizika, biologjia), ekonomiku, shkencat sociale, menaxhimi, marketingu, shkencat kompjuterike, IT etj.

Një kujdes i veçantë është treguar për të përfshirë në të dhe libra mbi degë të tjera, si sociologjia, psikologjia, letërsia, arti, mjekësia, etj. Koleksioni i bibliotekës është pasuruar me tituj të ndryshëm, në saj të fushatave për blerjen dhe donacione nga institucione, individë dhe profesorë të KU “IKT”. Titujt janë zgjedhur në përputhje me nevojat dhe kërkesat e studentëve, stafit administrativ dhe akademik.

Biblioteka ka rreth 3000 tituj, me rreth 20 tituj në gjuhën shqipe dhe rreth 2780 tituj në anglisht dhe me një sektor të veçantë të gjuhës së huaj, si frëngjisht, spanjisht, gjermanisht, italisht. Të gjithë titujt e bibliotekës përditësohen rregullisht në databazën e Bibliotekës dhe çdokush, në çdo kohë mund të ketë akses tek titujt që janë gjendje në Bibliotekën e Institucionit.

KU “IKT” ka abonim në burimet elektronike të McGraw-Hill Education, nga ku janë përzgjedhur me kujdes burimet e duhura elektronike, që kanë lidhje me degët që studiohen në KU “IKT”.

Biblioteka e KU “IKT” ka **Hapësirën** e saj **Virtuale**, e cila është krijuar dhe përshtatur, bazuar në nevojat e Institucionit. Kjo bibliotekë virtuale, e cila aksesohet nga faqja e internetit e KU “IKT”, përmban rreth 300 tituj të rinj dhe bashkëkohorë në fushat e studimit të Institucionit. Librat e bibliotekës virtuale gjenden në formatin elektronik dhe në formatin printuar në bibliotekë.

Të gjitha librat elektronikë, që ekzistojnë në bibliotekën virtuale të KU “IKT”, janë nga bashkëpunimi me **McGraw-Hill Education**, një nga tre botuesit akademikë më të njohur botërorë. Një nga qëllimet kryesore të bibliotekës është që të ketë literaturën e duhur dhe në kohën e duhur për studentët dhe stafin. Për këtë arsye dhe për një proces sa më të suksesshëm akademik, në fund të vitit akademik, biblioteka dërgon një formular dixhital "*Formular për kërkesë librash*" për të gjithë personelin akademik, dekanët dhe përgjegjësit e departamentit, duke i lejuar stafit akademik deri në 2 muaj kohë të japin informacione në lidhje me titujt, që ata mendojnë të përdorin në klasa, e që duhet të jenë në gjendje në bibliotekë për vitin e ardhshëm akademik.

Pas krijimit të listës së materialeve akademike të kërkuar nga pedagogët, biblioteka fillon blerjet ndërkombëtare, duke u siguruar që të gjithë titujt e duhur do të jenë në kohën e duhur në Institucion për stafin akademik si dhe për studentët.

Në lidhje me investimet që janë bërë për bibliotekën e IKT, që nga viti 2012 është investuar në tituj të përditësuar në fushën e Inxhinierisë dhe Ekonomisë, duke bashkëpunuar drejtpërdrejtë me:

- 1) Cengage Learning,
- 2) Amazon
- 3) Educational Center Albania.

Edhe pse biblioteka e KU “IKT” është e pasur me literaturë të fushave të ndryshme të studimit, kujdes i veçantë kushtohet për të krijuar hapësira më të mëdha me literaturë që studiohet në KU “IKT”, duke ofruar kështu mundësinë për studentët që të zhvillojnë më tej njohuritë e tyre në fushën e studimit të zgjedhur.

Shërbimi bibliotekar kryhet prej punonjësve të caktuar posaçërisht nga institucioni dhe ofrohet për studentët, stafin akademik dhe komunitetin. Biblioteka ndodhet në katin e katërt dhe ka një

sipërfaqe prej 90 m². Biblioteka ka një kapacitet prej 20 vendesh, ku 6 vende janë për përdorim kompjuteri dhe interneti.

Oraret e Bibliotekës, janë përshtatur me nevojat e studentëve. Biblioteka qëndron e hapur për studentët dhe stafin gjatë gjithë javës dhe ofron shërbim edhe për komunitetin pranë institucionit, duke ofruar akses të hapur për titujt e saj. Biblioteka qëndron e hapur çdo ditë, E Hënë –E Premte, ora 09:00 – 13:00 dhe 14:00 – 18:00 dhe të Shtunën 08:00-15:00. Studentët dhe stafi mund të shfletojnë materialet e bibliotekës në një sallë leximi komode, të pajisur me të gjithë infrastrukturën e nevojshme. Fondi i librave është ‘Fond i hapur’, që do të thotë se studenti ka mundësi të përzgjedhë librat vetë në raftë, të sistemuar sipas Sistemit Decimal. Kjo e bën akoma më të lehtë shfrytëzimin e librave dhe revistave.

Biblioteka e ofron shërbimin e saj pa pagesë, jo vetëm për studentët e KU “IKT”, por për të gjithë të interesuarit nga zonat përreth, që duan ta shfrytëzojnë atë. Studentët dhe stafi mund të kenë akses 24 orë në internet në Bibliotekën Kërkimore (Databasi i Bibliotekës) përmes faqes së internetit të Bibliotekës së KU “IKT”.

Në faqen e internetit, seksioni i dedikuar bibliotekës (E-Resources) jep të dhëna dhe ndihmon studentët edhe me libraritë që ofrojnë falas tekste mësimore, siç janë ato të:

- *Consortium for Open Education Resources*
- *BCcampus – OpenEd*
- *Open Textbook Catalog*
- *The Free Library*
- *Open Textbook Catalog*
- *BCcampus – OpenEd*
- *Full-Text Books Google*
- *Free Archive.org*
- *Internet Archive: Text Archive*
- *Free Scholarly E-Resources*

Mjafton që studenti të klikojë mbi linkun ku shkruhet emri i librarisë dhe ajo e shpie direkt në destinacion dhe ai mund të shfrytëzojë këto biblioteka të pasura online dhe pa pagesë.

Ngjashëm me këtë është edhe pjesa e librarive, që ofrojnë burime dhe revista pa pagesë, të tilla si:

- *CORE*
- *ScienceOpen*
- *RePEc (Research Papers in Economics)*
- *Directory of Open Access Journals (DOAJ)*
- *OpenDOAR*
- *Education Resources Information Center (ERIC)*
- *EconBiz*
- *Open Access (Free) Resources in Science*

Këto burime i ndihmojnë studentët jo vetëm të studiojnë dhe të zgjerojnë njohuritë e tyre, por ato janë një pjesë shumë e rëndësishme e Bibliotekës Virtuale si dhe mund të shfrytëzohen pa limit për projektet, detyrat e kursit si dhe temën e diplomës.

Studentët dhe stafi mund të kenë akses 24 orë në internet në Bibliotekën Kërkimore (Databaza e Bibliotekës) përmes faqes së internetit të Bibliotekës IKT.

Që nga hapja e bibliotekës deri më sot, shumë aktivitete janë organizuar brenda saj ndër vite. Takime të rregullta janë bërë midis studentëve dhe drejtueses së Bibliotekës. Qëllimi i këtyre takimeve në formë ëorkshop-i, apo takim grupi, mbetet zgjerimi i njohurive të studentëve për përdorimin e bibliotekës, apo dhe ndihma që u duhet gjatë punës kërkimore në bibliotekë. Studentët gjithashtu janë prezantuar me revistat në të cilat biblioteka e IKT ka abonime dhe janë informuar për burime të tjera, që u janë vënë në dispozicion në faqen e internetit të IKT, siç janë librat me akses falas, bazat e të dhënave me akses të plotë dhe artikuj të tjerë të paraqitur nga profesorët. Gjatë ëorkshope-ve, drejtuesja e bibliotekës i ka njohur studentët me bazën e të dhënave të bibliotekës dhe se si studentët mund të bëjnë një kërkim për tituj të nevojshëm, brenda IKT, ose jashtë saj. Përveç kësaj, takime të rregullta janë zhvilluar me studentët dhe stafin akademik, duke i njohur me përdorimin e Bibliotekës Virtuale të IKT. Seminare për Bibliotekën Virtuale të IKT janë drejtuar nga përfaqësuesit e McGraw-Hill Education, të cilët janë ftuar dhe kanë udhëtuar rregullisht drejt Shqipërisë për të zhvilluar trajnimet e kërkuara për produktin e tyre. Ndërsa udhëzues PDF për përdorimin e bibliotekës online, janë krijuar dhe u janë shpërndanë studentëve dhe stafit për të mbështetur më tej atë ç'ka u është prezantuar gjatë seminareve.

Gjatë këtij viti akademik IKT është pasuruar edhe me tituj të rinj dhe koherent në formatin elektronik dhe print, një pjesë e këtyre titujve janë dhuruar prej UNICEF Albania.

Për çdo titull elektronik, Biblioteka e IKT, ka një kopje të shypur të librit dhe studentët kanë akses në të dy format e leximit. Biblioteka e IKT ofron për stafin akademik database të hapura, baza të dhënash akademike falas, libra të hapur, revista falas, baza të dhënash kërkimore, si dhe kurse të hapura online të ndjekura në universitete shumë të njohura në mbarë botën.

Kryetari i Bordit të Administrimit

Prof.Assoc. Ramiz ZEKAJ

Kryetari i Senatit Akademik

Prof.Dr. Sokol ABAZI